

University for Business and Technology in Kosovo

## UBT Knowledge Center

---

Theses and Dissertations

Student Work

---

2010

### Sistemi bankar dhe politika kreditore në Kosovë

Jeton Uka

*University for Business and Technology - UBT*

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd>



Part of the [Business Commons](#)

---

#### Recommended Citation

Uka, Jeton, "Sistemi bankar dhe politika kreditore në Kosovë" (2010). *Theses and Dissertations*. 2526.  
<https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd/2526>

This Thesis is brought to you for free and open access by the Student Work at UBT Knowledge Center. It has been accepted for inclusion in Theses and Dissertations by an authorized administrator of UBT Knowledge Center. For more information, please contact [knowledge.center@ubt-uni.net](mailto:knowledge.center@ubt-uni.net).



FAKULTETI PËR MENAXHMENT, BIZNES DHE EKONOMI

# PUNIM DIPLOME

(Niveli Bachelor)

Mentori:  
Prof. Dr. Musa Limani

Kandidati:  
Jeton Uka

Prishtinë, 2010



FAKULTETI PËR MENAXHMENT, BIZNES DHE EKONOMI

# PUNIM DIPLOME

(Niveli Bachelor)

Departamenti: Banka, Financa dhe Kontabilitet

Tema: Sistemi bankar dhe politika kreditore në Kosovë

Mentori:  
Prof. Dr. Musa Limani

Kandidati:  
Jeton Uka

Prishtinë, 2010

## PËRMBAJTJA

PËRMBAJTA.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
HYRJE.....	3

### PJESA E PARË

I. SISTEMI BANKAR NË KOSOVË.....	4
1. Kuptimi dhe definicioni i bankave .....	6
2. Llojet e bankave.....	7
3. Përkufizimi i bankave komerciale .....	8

### PJESA E DYTË

II. STRUKTURA E BANKAVE KOMERCIALE NË KOSOVË.....	10
1. Struktura e bankave sipas asetëve .....	12
1.1. Bilanci i gjendjes (Balance sheet) dhe elementet bazë të veprimtarisë së një banke.....	12
1.2. Bilanci i Bankës.....	13
1.3 Aktivet plotësisht likuide ose rezervat parësore .....	14
1.4. Aktivet likuide ose rezervat dytësore .....	14
1.5. Aktivet e tjera .....	15
2. Struktura e bankave sipas depozitave .....	15
2.1. Depozitat e çekueshme .....	15
2.2. Depozitat e paçekueshme .....	16
2.3. Depozitat e kursimit .....	16
2.4. Depozitat me afat.....	16
2.5. Huatë.....	16
2.6. Huatë ndërbankare .....	17
3. Struktura e bankave sipas kredinave .....	17

### PJESA E TRETË

III. STRUKTURA NË VEÇANTI PËR ÇDO BANK KOMERCIALE.....	18
1. Struktura e kapitalit .....	18
2. Struktura e depozitave .....	19
2.1. Sistemi bankar i depozitave në % të GDP-së në vendet e ballkanit perëndimor.	21
3. Struktura e kredinave.....	23
4. Struktura e kushteve të kreditimit.....	25
4.1. Procedura e kreditimit .....	26
4.2. Kreditimi bankar me afat të shkurtër .....	27
5. Norma e kamatës .....	27

## PJESA E KATËRT

IV. SHËRBIMET BANKARE .....	32
1. Qëllimi i shërbimeve moderne bankare .....	32
2. Shërbimet bankare .....	32
2.1. Llogaritë bankare .....	34
2.2. Kartelat bankare.....	36
2.3. Kartela debiti .....	38
2.4. Kartela krediti .....	39
2.5. Bankomatat (ATM) .....	41
2.6. POS Terminalat .....	42
2.7. Kredia dhe llojet e kredive.....	43
2.8. Kredia private .....	43
2.9. Kredia konsumuese .....	44
2.10. Kredia për biznes .....	44
2.11. Kredia renovimi .....	45
2.12. Kredia për bujqësi.....	45
2.13. Kredia për automjete .....	46
2.14. Kredia për student.....	46
2.15. Mbitërheqja (Overdraft) .....	46
2.16. Interneti bankar (E-banking) .....	47
2.17. Çeqet bankare .....	48
2.18. Transferat bankar .....	49
2.19. Pagesa e rrogës përmes bankës.....	50
2.20. Urdhërat automatik (Standing Orders) .....	50
2.21. Garancionet bankare .....	51
PËRFUNDIMI.....	52
LITERATURA .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>

## HYRJE

Ky punim përmban vështrimin kritik të sistemit bankar të bankave dhe politikat kreditore, me vështrim të veçantë në Kosovë. Në këtë punim janë cekur kryesisht faktorët që ndikojnë në funksionin dhe zhvillimin e sistemit bankar të bankave komerciale në Kosovë duke përfshirë strukturën e bankave komerciale sipas aseteve, depozitave dhe kredinave. Një qasje i është dhënë edhe identifikimit të faktorëve që ndikojnë në kushtet e kreditimit në relacion ndërkombëtar, duke e krahasuar normën e kamatës, depozitave dhe kredinave.

Ky punim ofron një pasqyrë reale rreth funksionimit të sistemit bankar në Kosovë dhe ofron disa udhëzime mbi politikën e zhvillimit të sistemit bankar me qëllim të arritjes së aftësisë konkurruese.

Punimi i diplomës me temë “**Sistemi bankar dhe politika kreditore në Kosovë**” përfshinë prezantimin e njohurive teorike në udhëheqjen praktike në sistemin bankar, si format e udhëheqjes, menaxhimin e bankave, format e organizimit, mënyrat e bashkëpunimit me autoritetin bankar dhe format e bashkëpunimit. Të gjitha këto njohuri kanë të vetmin qëllim që të krijojë njohuri të reja për menaxhim profesional të sistemit bankar, që në të ardhmen si menaxher i bankës të jem i suksesshëm.

Njohuritë e përfituara teorike, gjatë shkollimit të pasqyruara në punimin e diplomës do të më krijojnë aftësi profesionale në nivel të mjaftueshëm që si menaxher i cili do të udhëheq në të ardhmen në ndonjë bankë komerciale, të jem kompetent i pa diskutueshëm dhe mirë i profeksionuar për ushtrimin e aktiviteteve të gjithanshme në shërbim të bankës, klientëve, bizneseve, mjedisit, shoqërisë, komuniteteve dhe institucioneve tjera shtetërore.

Objektiv tjetër i këtij punimi është zhvillimi i personalitetit të një menaxheri të ardhshëm që si udhëheqës apo menaxher, me kompetencë të plotë të inkuadrohem në një shoqëri demokratike, të aftë profesionale në mënyrë që me sukses të angazhohem në lëmin e sistemeve bankare duke dhënë kontributin tim në:

- *ushtrimin dhe zhvillimin e sistemit bankar në Kosovë,*
- *marrjen e kompetencave dhe përgjegjësisë profesionale,*
- *përballimin e vështirësive që do të ndeshem gjatë menaxhimit të ndonjë banke komerciale në të ardhmen pavarësisht nga kushtet dhe rrethanat.*

## **PJESA E PARË**

### **I. SISTEMI BANKAR NË KOSOVË**

Që në fillim duhet potencuar se zanafilla e formimit të sistemit bankar në Kosovë daton me aprovimin e rregullores së UNMIK-ut nr 1999/20 në nëntor të vitit 1999, ku u themelua institucioni i parë financiar që u quajt Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës (ABPK). Andaj me themelimin e këtij institucioni u vunë themelet e sistemit modern bankar sipas standardeve evropiane dhe kërkesës së ekonomisë së tregut. Lidhur me këtë mund të themi se, deri te themelimi i Bankës Qëndrore në Kosovë, ky institucion (ABPK) e luajti rrolin e Bankës Qëndrore.

Faktikisht sistemi bankar në Kosovë formohet dhe funksionon pas aprovimit të Kushtetutës së Kosovës, pra pas 15 qershorit të vitit 2008 me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 03/1-074, u bë transformimi i Autoritetit Qëndror Bankar të Kosovës në Bankën Qëndrore të Kosovës (BQK), andaj në bazë të nenit 65 pika 1 dhe nenit 140 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, thuhet se Banka Qëndrore e Kosovës është institucion i pavarur, që për punën dhe veprimtarinë e vet i raporton Kuvendit të Kosovës.

Kosova ende nuk e ka tregun e kapitalit, që do të thotë se sistemi financiar në Kosovë është i bazuar vetëm në sistemin bankar, i cili është i përbërë kryesisht nga bankat e jashtme. Mirëpo si do që të jetë bazuar në dinamikën e themelimit dhe funksionimit të bankave, tërë sistemi bankar në Kosovë, në periudhën e pasluftës mund ta ndajmë në dy periudha kryesore:

a) Periudha e viteve 2000-2006 në të cilën bankat e jashtme ishin të parat në tregun financiar të Kosovës, ndonëse u formuan edhe disa banka vendore. Banka e parë që e filloj punën në Kosovë ishte Micro Enterprise Bank, e cila filloj në vitin 2000 dhe deri në vitin 2001 operoi si e vetmja bankë në Kosovë. Kjo bankë në vitin 2003 u transferua në ProCredit Bank, që është kapital i përzier i disa institucioneve financiare ndërkombëtare. Pas kësaj banke në vitin 2001 u licencuan dhe filluan punën e tyre në Kosovë dhe 6 banka të reja siç janë: Raiffeisen Bank, Banka Ekonomike, Kasabank, Banka e Re e Kosovës, Banka Amerikane e Kosovës, Banka për Biznes dhe Banka Kreditore e Prishtinës. Kjo e fundit falimenton në mars të vitit 2006. Në periudhën e viteve 2000-2006 në Kosovë operuan 7 Banka, ku dy prej tyre ishin në pronësi të huaj

(ProCredit Bank dhe Raiffeisen Bank) të cilat kontrollojnë më tepër se 70.0% të tregut financiar në Kosovë dhe

b) Periudha e viteve 2006-2008, që karakterizohet si fazë e konsolidimit të sistemit bankar e që karakterizohet me rritjen e numrit të bankave komerciale në Kosovë. Gjatë kësaj periudhe u formuan dhe këto banka komerciale: Banka Tregtare e Shqipërisë dhe Banka Komerciale e Serbisë (fondi i vitit 2007), Banka Ekonomike Turke dhe Nova Ljubljanska Banka NLB me financimin e Kasabankës dhe Bankës së Re të Kosovës (në janar të vitit 2008).

Prandaj duke pasur parasysh atë që u cek më sipër, në përdihen e pasluftës, në kuadër të sistemit bankar të Kosovës, aktualisht veprojnë gjithsej 8 banka komerciale, prej të cilave 6 janë në pronësi të huaj dhe vetëm 2 në pronësi vendore. Prandaj me të drejtë mund të konstatojmë se në sistemin bankar të Kosovës dominojnë bankat e huaja, përkatësisht kapitali i huaj. Kështu, pjesëmarrja e bankave të huaja në vitin 2008 në gjithsej asetet e sektorit bankar të Kosovës ishte mbi 90.0%<sup>1</sup>

Një dukuri negative që vërehet sidomos te bankat me kapital vendor është shfrytëzimi i bankave nga ana e vet aksionarëve (themeluesve) të bankave. Ka shumë raste kur aksionarët e një banke të caktuar kanë marrë më tepër kredi nga banka e vet, sesa është kapitali i tyre në themelimin e bankave.

Pengesë apo barrierë tjetër është ruajtja dhe kursimi i parave të fondit pensional, të cilat janë grumbulluar pas luftës dhe Trusti i kursimeve pensionale i ruan në bankat jashtë Kosovës.

Gjatë periudhës së pasluftës bankat komerciale në Kosovë kanë përmirësuar rrjetin e tyre bankar të punës duke vënë në përdorim teknologjinë më të re. Vendosija e teknologjisë së re ka mundësuar që bankat të rrisin sigurinë në dhënien e shërbimeve, zgjerojnë gamën e produkteve që ato japin dhe shkurtojnë shpenzimet e përgjithshme. Për më tepër, teknologjia e re i ka mundësuar klientët t'i përdorin shërbimet bankare derjtpërdrejtë dhe në mënyrë të vazhdueshme gjatë 24 orëve. Deri në dhjetor të këtij viti, numri i bankomatëve në sektorin bankar arriti në 43. Duke ndjekur tendencën e zhvillimit botëror bankar, si dhe tendencën ndryshe të popullsisë në Kosovë drejt përdorimit të shërbimeve bankare, bankat iu kanë dhënë klientëve të tyre shërbime të reja si p.sh. kartat e kreditit dhe të borxhit, siç janë Visa dhe MasterCard.

---

<sup>1</sup> Për këtë më gjerësisht shih: raportet vjetore dhe përdorime të Bankës Qëndrore të Kosovës.



## 1. Kuptimi dhe definicioni i bankave

Bankat janë një nga institucionet më të rëndësishme për ekonominë e një vendi, pasi që ato janë burimi kryesor i kredive për individët, familjet, institucionet dhe bizneset e ndryshme. Lidhur me këtë mund të thuhet se banka paraqet institucion financiar të veçantë, i cili merret me mobilizimin e mjeteve monetare, përkatësisht me ndërmjetësimin e marrjes dhe të dhënies së kredisë dhe qarkullimit të pagesave të komitentëve.<sup>2</sup>

Në kushtet bashkëkohore e sidomos në vendet ekonomikisht të zhvilluara ekziston një numër i madh i institucioneve financiare private të cilat për nga përmbajtja e punës së tyre nuk mund të quhen banka. Pikërisht për këtë arsye duhet të përcaktohet sa më qartë definicioni i bankës për të parë dallimin në mes të bankës dhe ndonjë organizate tjetër financiare.

Për tu përcaktuar më saktë koncepti i bankës dhe për tu formuluar definicioni sa më i afërt me kushtet bashkëkohore në të cilat punojnë bankat, duhet të caktohen kriteret në bazë të të cilave bankat dallohen nga ndërmarrjet prodhuese, tregtare dhe ato që merren me veprimtari shërbyese.

Edhe pse nga aspekti i teorisë dhe i praktikës është shumë vështirë që të tërhiqet vija e demarkacionit në mes të bankave dhe organizatave të tjera financiare, përmes disa kriterëve mund ti afrohemi një definicioni të pranueshëm për bankën. Këto kriterë janë:

- *si institucion financiar me punët e saja sa ndikon në krijimin e parave*
- *a është veprimtaria e saj themelore marrja dhe dhënia e kredive*
- *a ka mbështetje të mirë financiare për realizimin e qëllimeve kryesore të politikës ekonomike dhe zhvillimore të vendit*
- *çfarë janë mundësitë e bankës për zhvillimin dhe përparimin e qarkullimit të pagesave dhe shpejtimin e qarkullimit monetar.*

Zakonisht me konceptin bankë janë të lidhura punët rreth krijimit të parave, grumbullimit të depozitave, dhënies së kredive dhe kryerjes së shërbimeve për pagesa. Duke u bazuar në punët e lartpërmendura, mund të ipet një përkufizim më i përafërt për bankën:

---

<sup>2</sup> Dr. Musa Limani, Makroekonomia aplikative, Prishtinë, 2008, fq. 129.

*“Banka është një institucion financiar i sistemit monetar kreditor që merret me marrjen dhe dhënien e kredive, në kryerjen e shërbimeve të pagesave dhe krijimin e parave”.*<sup>3</sup>

Bankat, krijimin e parave e sigurojnë nëpërmes depozitave bankare, kjo arrihet nëpërmes operacioneve kreditore duke bërë blerjen ose shitjen e letrave me vlerë të klientëve të cilët krijojnë depozita. Bankat në bazë të depozitave dhe kredinave krijojnë para të cilat i kanë në dispozicion për zhvillimin e ekonomisë dhe shfrytëzuesit e kredive.

Shërbimet të cilat i kryejnë bankat mbështeten në:

- këmbimin e kartëmonedhave,
- marrjen e depozitave të kursimit,
- ruajtjen e gjërave me vlerë,
- dhënien e kredive konsumuese,
- financimin e biznesit,
- ofrimin e polisave të sigurimit,
- kryerjen e shërbimeve tregtare, etj.

## **2. Llojet e bankave**

Bankat bashkëkohore në kohën e sotme kryejnë shërbime financiare si dhe kujdesen për mjetet monetare, për komitentët e vet. Suksesit i tyre varet nga aftësia që të identifikojnë shërbimet financiare të cilat ju nevojiten komitentëve, t'i kryejnë ato shërbime në kushte sa më efikase dhe më të volitshme.

Roli që luajnë bankat në zhvillimin ekonomik të një vendi si dhe niveli afarist i tyre e përcakton llojin e bankës.

Rolet kryesore të bankave të sotme mbështeten në:

- ***shndërrimin e kursimeve të klientëve në kredi për investime të reja,***
- ***kryerjen e pagesave për komitentët e vet,***

---

<sup>3</sup> Dr. Gazem Luboteni, Bankat dhe afarizmi bankar, Prishtine, 2006, fq. 134.

- *pagimin e borxheve dhe garantimin për komitentët e vet kur ata nuk janë në gjendje ti paguajnë,*
- *kujdesin për pasurinë e komitentëve të vet.*

Ndërlikueshmëria dhe llojllojshmëria e aktiviteteve që i kryejnë bankat bashkëkohore gjatë afarizmit të tyre janë kritere të cilët përcaktojnë klasifikimin e bankave varësisht se si i sigurojnë ato mjetet të nevojshme financiare. Në bazë të kësaj bankat i ndajmë në:<sup>4</sup>

- *Banka qëndrore,*
- *Banka afariste,*
- *Banka investive,*
- *Banka universale,*
- *Banka hipotekare,*
- *Banka kursimtare,*
- *Banka për zhvillim,*
- *Banka multinacionale dhe*
- *Banka komerciale (depozitare).*

### **3. Përkufizimi i bankave komerciale**

Bankat komerciale (depozitare) janë banka që bëjnë kreditimin afatshkurtër të prodhimit dhe konsumit. Këto banka mjetet i krijojnë prej depozitave afatshkurtër të ekonomisë dhe depozitave të kursimit të popullsisë. Në bazë të burimeve të mjeteve që janë afatshkurtër, japin kredi me afat të shkurtër për blerjen e mallrave dhe për këtë arsye quhen *banka komerciale*.

---

<sup>4</sup> Dr. Gazem Luboteni, Bankat dhe afarizmi bankar, Prishtine, 2006, fq. 135.

Bankat komerciale paraqesin bankat më të shumta dhe më të përhapura në botë. Ato janë bazë e sistemit të ndërmjetësimit financiar, sepse me punët e tyre i mobilizojnë depozitat dhe pastaj lejojnë kredi për plotësimin e nevojave të ekonomisë.<sup>5</sup>

Karakteristikë e këtyre bankave është se kanë shumë komitentë dhe filiale të organizuara sipas principit territorial. Duke bërë kreditimin afatshkurtër, ato njëkohësisht bëjnë emisionin e parave, duke ndikuar kështu në ndryshimin e masës monetare dhe likuiditetin e vendit.

Dinamika e ecurive ekonomike bashkëkohore shtron detyra gjithnjë e më të ndërlikuara ndaj bankave komerciale, por njëkohësisht parimit të likuiditetit dhe të sigurisë së plasmanëve, si dhe parimit të rentabilitetit.

Nga ana tjetër, konkurrenca gjithnjë e më e madhe në tregun e parave dhe të kapitalit e detyron bankën që të ketë një politikë sa më elastike kreditore, që nënkupton përcjelljen e vazhdueshme të ecurive ekonomike, gjendjen në tregun e vendit, tregjet e jashtme dhe njohjen sa më të mirë të afarizmit të secilit komitent të bankës.

---

<sup>5</sup> Dr.Gazment Luboteni, Bankat dhe afarizmi financiar, Prishtinë, 1998, fq. 87.

## PJESA E DYTË

### II. STRUKTURA E BANKAVE KOMERCIALE NË KOSOVË

Sistemi financiar në Kosovë përfshinë në vete bankat dhe institucionet tjera financiare, ku sigurohen mjetet monetare afatshkurtëra dhe afatgjata për ekonomi. Sistemi bankar pas rrënimt të dhunshëm karakterizohet me mungesën e plotë të kapitalit financiar, dëmtimit fizik të objekteve bankare si dhe personelit bankar të pakualifikuar për operacione bankare moderne. *UNMIK-u themeloi Autoritetin Bankar dhe Pagesave të Kosovës (BPK)*, dhe bëri hapa shumë të rëndësishme në sistemin bankar, dhe pastaj vuri stabilitet makro-ekonomik me aplikimin e Markës Gjermane, si valutë zyrtare, dhe ndërrimin e saj të suksesshëm në Euro.

Për lëshimin e licencës për punë BPK-ja ka qenë shumë rigoroze, gjë që ka mundësuar krijimin e një ambienti të mirëfillt ligjor. Sektori bankar komercial në Kosovë është nga më të rregulluarit dhe më vitalët në rajon, në depozita të cilët shënojnë rritje të vazhdueshme. Kjo lidhet me kthimin e besimit të ekonomisë dhe popullsisë, përkatësisht depozitorëve, në sistemin bankar i cili ishte i humbur në periudhën e sistemit të vjetër. Rritja e depozitave është veçmas intensive gjatë dy viteve të fundit për shkak të vlerës së qëndrueshme të Euros në krahasim me valutat tjera.

Gjatë vitit 2004, 2005 zhvillimi i bankave ka shkuar në drejtim të zgjerimit të rrjetit të tyre në territorin e Kosovës, kështu që është rritur dukshëm numri i filialave dhe ekspoziturave të tyre, duke e realizuar një shtrirje në të gjitha komunat e Kosovës. Veprimataria e bankave është përqëndruar në realizimin e transferit të parave dhe kryerjen e pagesave brenda dhe jasht vendit, ruajtjen e depozitave dhe kreditimin e komitentëve të vet. Lloji tjetër i pjesëmarrësve në ndërmjetësimin financiar janë *Institucione mikro-financiare (IMF)*. IMF nuk mund të mbajnë depozita (sikurse bankat), por merren me aktivitet kreditor i cili në vitin 2005 ka një vlerë të konsiderueshme të kredive që janë të angazhuar në ekonominë e Kosovës. Numri i këtyre ka shënuar rritje të vazhdueshme.<sup>6</sup>

Pas themelimit të Bankës Qëndrore të Republikës së Kosovës (BQK), e cila është pasardhëse e Autoritetit Qëndror Bankar të Kosovës, struktura e bankave komerciale në Kosovë përbëhet nga këto baka:

---

<sup>6</sup> BQK BULETINI – Raporti Vjetor 2004 - 2009

1. PROCREDIT BANK (PCB) - Me Seli në Prishtinë dhe filialat në: Prizren, Gjilan, Gjakovë, Mitrovicë, Ferizaj, Pejë, Podujevë, Fushë Kosovë, Klinë, Skenderaj, Istog dhe ekspoziturat në të gjitha komunat tjera. Objektivi kryesor i ProCredit Bankës është përkrahja financiare për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, të cilat kanë një rrjedhë të rregullt të parasë, dhe që ato ndërmarrje të kenë minimum 6 muaj që kanë filluar biznesin e tyre.

2. BANKA PRIVATE E BIZNESIT (BPB) – Me seli në Prishtinë dhe filialat në: Prizren, Gjilan, Gjakovë, Mitrovicë, Ferizaj, Pejë, Podujevë, Fushë Kosovë, Klinë, Skenderaj, Istog dhe ekspoziturat në të gjitha komunat tjera.

3. BANKA E RE E KOSOVËS (BRK) - Me seli në Prishtinë dhe filialat në: Prizren, Gjilan, Gjakovë, Mitrovicë, Ferizaj, Pejë, Podujevë, Fushë Kosovë, Klinë, Skenderaj, Istog dhe ekspoziturat në të gjitha komunat tjera.

4. BANKA EKONOMIKE SH.A. PRISHTINË (BE) – Me seli në Prishtinë dhe filialat në: Prizren, Gjilan, Gjakovë, Mitrovicë, Ferizaj, Pejë, Podujevë, Fushë Kosovë, Klinë, Skenderaj, Istog dhe ekspoziturat në të gjitha komunat tjera.

5. NLB PRISHTINA – Me seli në Prishtinë dhe filialat në: Prizren, Gjilan, Gjakovë, Mitrovicë, Ferizaj, Pejë, Podujevë, Fushë Kosovë, Klinë, Skenderaj, Istog dhe ekspoziturat në të gjitha komunat tjera.

6. RAIFFEISEN BANK (RBKO) – Me seli në Prishtinë dhe filialat në: Prizren, Gjilan, Gjakovë, Mitrovicë, Ferizaj, Pejë, Podujevë, Fushë Kosovë, Klinë, Skenderaj, Istog dhe ekspoziturat në të gjitha komunat tjera.

7. TEB - Me seli në Prishtinë dhe filialat në: Prizren, Gjilan, Gjakovë, Mitrovicë, Ferizaj, Pejë, Podujevë, Fushë Kosovë, Klinë, Skenderaj, Istog dhe ekspoziturat në të gjitha komunat tjera.

## 1. Struktura e bankave sipas asetëve

### 1.1. Bilanci i gjendjes (Balance sheet) dhe elementet bazë të veprimtarisë së një banke:

Bilanci i një firme bankare përbëhet nga dy pjesë;

- *aktivi (assets)*,
- *pasivi (liabilities)*.

Në mënyrë të përmbledhur bilanci ka pak a shumë formën e mëposhtme që tregohet edhe emri, bilanci ka si karakteristikë kryesore barazimin e të dy anëve të tij, nga ku mund të shkruajmë që;

- *Aktivet = Pasivet + Kapitali*
- *Assets = Liabilities + Equity*

Ky barazim nënkupton që po të zbrisim nga aktivet detyrimet e firmës marrim pasurinë neto të saj ose kapitalin.

## 1.2. Bilanci i Bankës

Tabela: 1. Bilanci i bankës

<u>Aktiva - Assets</u>	<u>Pasiva – Liabilities</u>
I. <i>Aktive plotësisht likuide (Rezervat parësore)</i>	I. <i>Depozitat</i>
A. Arka	.A. Llogaritë në të parë
1. Arka në monedhë kombëtare	1. Llogari pa interes
2. Arka në monedhë të huaj	2. Llogari me interes
B. Depozitat në Bankën Qëndrore	B. Llogari depozitash
II. <i>Aktive Likuide (Rezervat dytësore)</i>	1. Depozita Kursimi
A. Letra me vlerë shtetërore	2. Depozita Kursimi me afat
1. Të qeverisë	3. Depozita të tregut Monetar
2. Të organeve lokale	II. <i>Borxhet (Huamarrjet)</i>
B. Kredi dhënë bankave të tjera	A. Huamarrjet prej Bankës Qëndrore
III. <i>Aktive tjera</i>	B. Huamarrjet prej Bankave tjera
A. Depozitat në bankat të tjera	C. Eurodollarët (Euro\$)
B. Interesa për tu arkëtuar	D. Borxhe afatgjatë
IV. <i>Kredi (Huadhënie)</i>	III. <i>Pasive tjera</i>
A. Biznesi	A. Taksa të papaguara
B. Hipotekash	B. Interesa për t'u paguar
C. Personale	C. Rezerva për humbjet nga kreditë
D. Bujqësore	IV. <i>Kapitali</i>
V. <i>Aktive fikse</i>	A. Kapitali i paguar
A. Ndërtesa	B. Fitimet e mbetura
B. Makineri e pajisjes	C. Të tjera
C. Të tjera	

Dallojmë dy lloje të aktiveve:<sup>7</sup>

1. *Aktivet plotësisht likuide ose rezervat parësore*
2. *Aktivet likuide ose rezervat dytësore*

<sup>7</sup> [www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)



### 1.3 Aktivitet plotësisht likuide ose rezervat parësore

Këtu futen të gjitha llojet e rezervave që mbanë banka në arkën e saj dhe si depozita në Bankën Qëndrore. Ky zë një peshë shumë të vogël në kuadrin e aktiveve të bankës.<sup>8</sup> Megjithëse, banka për rezervë përgjithësisht nuk merr asnjë interes, ajo mbanë një pjesë të aktiveve të saj në këtë formë për dy arsye:

- *për ti plotësuar rezervat që kërkon autoriteti rregullues, Banka Qëndrore sipas një norme për çdo njësi depozitash, të cilat quhen rezerva të detyrueshme. Në vende të ndryshme, norma e rezervës së detyrueshme është e ndryshme, për lloje të ndryshme depozitash. Aktualisht, në vendin tonë aplikohet një normë 10% për të gjitha llojet e depozitave.*
- *në rast tërheqje të drejtpërdrejtë të depozitave ose të pagesës së çeqeve për të plotësuar nevojat e saj për likuiditet, banka mban edhe rezerva të tepërta.*

### 1.4. Aktivitet likuide ose rezervat dytësore

Këto përbëjnë një zë të rëndësishëm të aktiveve të bankës sepse plotësojnë dy kushte të rëndësishme.

- *sjellin të ardhura (për to paguhet interes)*
- *duke qenë të tregtueshme në tregun sekondar kanë shkallë të lartë likuiditeti, prandaj dhe quhen rezerva dytësore.*

Në SH.B.A. arrinë në rreth 25% të aktiveve, ndërsa në Shqipëri rreth 50%. Në Kosovë ka një veçori që rrjedh nga tranzicioni. Për shkak të nivelit fillestar të zhvillimit të tregut të kapitaleve, fillimisht në këtë përfshihej financimi i domosdoshëm i borxhit shtetëror nga ana e bankës i cili ka qenë i lartë dhe ka ardhur gradualisht duke rënë. Pas kalimit në financimin e borxhit me bono të thesarit, përfshihet ajo pjesë e tyre që blihet nga banka, e cila nuk është likuide aq sa në vendet e tjera të zhvilluara, për shkak të mungesës së tregut sekondar. Ajo është mjaft e lartë, sepse banka e kursimit blenë shumicën e bonove të thesarit që emetohen. Përfshihen edhe huatë ndërbankare që janë afatshkurtëra (24 orë), për plotësimin e nevojave të likuiditetit të cilat janë likuide dhe përfaqësojnë një nga mënyrat më të përdorshme për menaxhimin e riskut.

---

<sup>8</sup> Dr. Sulo Hadri, *Ekonomia Monetare, Ribotimi 4*, Tiranë, 2003, fq. 97.

## 1.5. Aktivet e tjera

Bankat mund të mbajnë edhe depozita në banka të tjera. Kryesisht, bankat e vogla mbajnë depozita në bankat e mëdha për të siguruar shërbime të caktuara me kosto më të ulët. Bankat tona mbajnë depozita në bankat e huaja për të siguruar shërbimin e klientëve për transaksionet ndërkombëtare të importit dhe si një investim fitimprurës.

## 2. Struktura e bankave sipas depozitave

Depozitat përfaqësojnë burimin kryesor të mjeteve financiare për bankën duke zënë pjesën kryesore të pasiveve. Depozitat janë;

- *të çekueshme dhe*
- *të paçekueshme.*

### 2.1. Depozitat e çekueshme

Përfaqësojnë llogari bankare të cilat i japin të drejtën zotëruesit të tyre që të lëshojë çeqe për të tjerët. Këto depozita mund të jenë:

- *depozita në të parë (që nuk sjellin interes) dhe*
- *depozita të çekueshme (që sjellin interes)*

Depozitat e çekueshme kanë qenë burimi kryesor i pasives së bankës tregtare, por pesha e tyre ka ardhur duke rënë. Depozitat e çekueshme janë të pagueshme sipas kërkesës. Po që se një depozitues paraqitet në bankë dhe kërkon të bëjë një tërheqje banka e paguan atë menjëherë. Edhe pse në qoftë se një person paguhet me një çek të lëshuar mbi një llogari bankare, atij i transferohen paratë në llogarinë kur sapo paraqet çekun në bankën e tij.<sup>9</sup>

Depozitat e çekueshme përfaqësojnë një burim me kosto të ulët për bankën sepse depozituesit heqin dorë nga interesi për të siguruar një likuiditet të lartë. Kosto e tyre përfshinë si interesin e ulët që paguhet për disa depozita të çekueshme ashtu edhe kostot e shërbimit si mbushja dhe ruajtja e çeqeve, përgatitja dhe dërgimi i njoftimit mujor,

---

<sup>9</sup> Dr. Sulo Hadri, *Ekonomia Monetare, Ribotimi 4*, Tiranë, 2003, fq. 99.

pagesat e arkëtarëve, mirëmbajtja e ndërtesës, shpenzimet e reklamës, paga e nënpunësve, etj.

## **2.2. Depozitat e paçekueshme**

Përfaqësojnë burimin kryesor të fondeve të bankës. Karakteristikë kryesore e tyre është se ato sjellin interes të lartë, por nuk lejohet lëshimi i çeqeve. Këto depozita paraqiten kryesisht si :

- *depozita kursimi dhe*
- *depozita me afat*

## **2.3. Depozitat e kursimit**

Janë formë tipike e depozitave të paçekueshme në të cilat mund të bëhen derdhje dhe tërheqje në çdo kohë, të cilat pasqyrohen në një libër të veçantë që quhet librezë kursimi. Afati i tërheqjes mund të jetë nga një ditë deri në një muaj por sidoqoftë banka është e interesuar ti shërbejë klientëve në kohën minimale të mundshme.

## **2.4. Depozitat me afat**

Kanë afate të ndryshme maturimi që mund të jenë mujore ose disa vjeçare dhe në rast tërheqje të parakohshme aplikohen gjopa të konsiderueshme.

## **2.5. Huatë**

Bëjnë pjesë në pasive, përfaqëson marrjen e huave nga Banka Qëndrore në formën e huasë me konto kur banka ka nevojë për mjete financiare. Për këto hua paguhet një interes që njihet me emrin norma e kontos. Kjo normë që manipulohet nga Banka Qëndrore i shërben asaj edhe si instrument i politikës monetare sepse nëpërmjet ndryshimit të saj banka nxitë ose kufizon marrjen e huave prej saj.

## **2.6. Huatë ndërbankare**

Janë hua afatshkurtra që bankat i japin njëra tjetrës për nevoja likuiditeti me një interes të caktuar, i cili është i rëndësishëm sepse përcakton edhe lëvizjen e normave të tjera të interesit.

## **3. Struktura e bankave sipas kredinave**

Kreditë përbëjnë zërin kryesor të aktiveve të bankës. Në SH.B.A. ato zënë 61% dhe në Shqipëri rreth 8.2% të aktiveve. Niveli i ulët pjesës që zënë kreditë në vendin tonë e ka bazën si në politikën kufizuese të kreditit që ka adoptuar Banka e Shqipërisë ashtu edhe në zhvillimin e pamjaftueshëm të sistemit bankar për të financuar nevojat e ekonomisë nëpërmjet kredisë.

Kreditë përfaqësojnë një ndër aktivet tradicionale të bankës tregtare. Nëpërmjet tyre banka siguron pjesën dërrmuese të fitimeve sepse normat e interesit që aplikohen janë më të larta në krahasim me aktivet e tjera, për arsye se kreditë kanë një shkallë më të lartë risku dhe shkallë më të ulët likuiditeti. Ato nuk mund të kthehen para afatit të maturimit dhe në varësi të gjendjes ekonomike të subjektit që i merr, ekziston dhe shkalla e riskut të moskthimit.

## PJESA E TRETË

### III. STRUKTURA NË VEÇANTI PËR ÇDO BANK KOMERCIALE


#### 1. Struktura e kapitalit

Kapitali i bankës përfaqëson diferencën midis aktiveve dhe pasiveve ose burimet e brendshme të bankës. Kapitali përfaqëson një garanci të bankës kundrejt rënieve të mundshme të vlerës së aktiveve të saj, që e çojnë bankën në falimentim. Është kjo arsyeja që agjentët rregullues vendosin me ligj një normë të mjaftueshmërisë së kapitalit që banka është e detyruar ta plotësojë. Një komponent i rëndësishëm i kapitalit është edhe fondi rezervë për humbjet nga kreditë e pakthyer.

Struktura e kapitalit në krahasim me strukturën e depozitave po bëhet gjithnjë komponent më i rëndësishëm në bilancin e gjendjes të bankave komerciale. Resurset e bankave komerciale vazhdojnë të rriten në veti, megjithëse me një hap të ngadalshëm. Në fund të vitit 2009 depozitat e bankave komerciale arrijnë shumën 836.6 milion euro, e cila korrespondon të rritet për 19.8% në krahasim me vitin 2008. Megjithëse pjesa e këtyre pati rënie gjatë vitit 2005, depozitat e bankave komerciale në Kosovë arritën shumën 85.0% të shumës së përgjithshme të bilancit të gjendjes të bankave. Bilanci nga bankat tjera rritet në 61.4% dhe në fund të vitit 2005 arrinë shumën 23.0 milion euro. Vazhdon rritja e bilancit të bankave tjera, bilanci i gjendjes është i mirë, arrinë shumën 2.3% në vitin 2005, pra arrinë 1.8% më lartë se sa ishte në vitin 2008.<sup>10</sup>

**Fig. 1. Struktura e kapitalit të bankave komerciale, 2005-2009, në Euro milion**

• Depozitat • Bilanci i bankave tjera • Kapitalet tjera



*Burimi: BQK(2010).*

<sup>10</sup> Structure of Commercial Banking Sector, 2005


Huatë tjera arrijnë shumën vetëm 0.6% të shumës së përgjithshme të bilancit të gjendjes dhe në fund të vitit 2009 ato përfshijnë 6.4 milion euro. Burimet e bankave komerciale arrijnë shumën 73.6 milion euro, që korrespondojnë me rritje prej 7.9%. Burimet e bankave arrijnë shumën 7.5% të shumës së përgjithshme të bilancit të gjendjes.

## **2. Struktura e depozitave**

Nga periodat e mëparshme depozitat në sistemin bankar vazhdojnë të rriten, por me një hap më të ngadalshëm. Megjithkëtë, pjesët e depozitave të GDP-së janë duke u rritur dhe në vitin 2009 ato përfshijnë 34.1% të GDP-së në krahasim me 27.7% që ishin në vitin 2008.

Brenda *strukturës së maturimit të depozitave*, depozitat me term të gjatë të maturimit gradualisht rriten gjatë atyre pjesëve. Veçanërisht, depozitat e transferuara rriten vetëm për 5.6% në vitin 2009, që llogaritet 35.5% e shumës së përgjithshme të depozitave, në krahasim të 40.2% që ishin në vitin 2008. Për arsye të rritjes së shpejtë në këtë vit, depozitat e transferuara arrijnë shumën 294.6 milion euro, kemi një krahasim të madh me nivelet e vitit 2008 që ishin 17.9 milion euro. Depozitat tjera cilat janë komponente të mëdha të shumës së përgjithshme të depozitave që janë gradualisht duke u zmadhuar në pjesët e shumës së përgjithshme të depozitave, kështu në fund të vitit 2009 ato llogariten 64.5% në krahasim me 59.8% që ishin në vitin 2008. Pjesët e gjata të këtyre dy tipeve të depozitave kanë ardhur nga korporatat jo financiare.

**Fig.2. Struktura e depozitave të maturimit, 2005-2009, në Euro milion**



Burimi: BQK(2010).

Brenda këtyre strukturave, depozitat me maturitet të një viti më të lartë përfaqësojnë përqindjen prej 85.5%, nëse i barazojmë pjesët e rëndësishme kemi zvogëlim nga viti i mëparshëm 9.9% në krahasim me vitin 2008, pra kemi ulje. Edhe sikur, depozitat me maturitet të një viti më të lartë mbeten komponentet më të mëdha prej depozitave tjera. Pjesën tjetër kemi zvogëlim të depozitave me një term të vogël të maturimit i cili ishte në rritje të depozitave me maturitet mbi një vit ose mbi dy vjet. Korespondenca e këtyre dy komponentëve prej depozitave tjera përfshinë 10.7% dhe 3.8%, në krahasim me 3.6% dhe 1.0% që ishin në vitin 2008.<sup>11</sup>


Duke i shikuar tipet e depozitave, në fund të vitit 2009 sektori i depozitave tjera (brenda së cilës përfshiheshin 97.4%), përbënin pjesën më të madhe të shumës së përgjithshme të depozitave të bankave komerciale. Kjo pjesë e shumës së përgjithshme të depozitave përfshinte 55.8% në krahasim me 54.4% që ishin në vitin 2008, kurse eksperiencia e rritjes mesatare nga 41.1% që ishte në vitin 2008 u rrit për 23.3% në vitin 2009. Dhe si rezultat, ato ishin 88.7 milion euro, krahasim shumë i madh me vitin 2008, shuma e përgjithshme 466.7% milion euro.

Pjesë tjetër e madhe është regjistrimi i depozitave të korporatave jofinanciare që në vitin 2009 llogariteshin 38.5% (1.8% më i ulët në krahasim me vitin 2008). Dhe si rezultat gjatë vitit 2009 ato rriten për 42.1 milion euro dhe arrijnë shumën 321.8 milion euro. Brenda strukturës së korporatave jofinanciare, korporatat shoqërore jo financiare rritën pjesët nga viti 2008 që ishin 62.2% që llogariten në vitin 2009 65.7%, ndërsa

<sup>11</sup> Structure of Commercial Banking Sector, 2005

rriten në 37.3 milion euro në 211.3 milion euro. Rritja e depozitave të korporatave shoqërore ishte duke ndjekur rritjen e dobët të depozitave tjera të korporatave jofinanciare, të cilat në vitin 2009 llogariten 34.3% ose 4.8 milion euro, krahasin i madh me vitin 2008.

Fig.3. Statistika në Dhjetor të vitit 2009 .



Burimi: PBK (2010)

Depozitat e korporatave financiare u rritën për 18.7% në vitin 2009, ndërsa rritja e depozitave të qeverisë ishte 118.7%, megjithëse ato akoma mbeten në nivelet e moderuara. Në termat e pjesëve të shumës së përgjithshme të depozitave, të dy depozitat prezantojnë 3.3% dhe 0.3%. Depozitat jo rezidente rriten në 41.1% gjatë vitit 2009 në krahasim me vitin 2008 që ishin 36.7% ndërsa prezantohen me 2.1% të shumës së përgjithshme të depozitave.


## 2.1. Sistemi bankar i depozitave në % të GDP-së në vendet e ballkanit perëndimor

Shikuar pjesët e depozitave të GDP-së, sistemi bankar i Kosovës qëndron pikërisht në nivelin mesatar të regjionit. Shuma e përgjithshme e depozitave të sistemit bankar në Kosovë arrinë 34.1% të GDP-së në vitin 2005, ndërsa mesatarja e regjionit është 42.4%. Duke i shikuar vendet tjera të regjionit, pjesën më të ulët të shumës së përgjithshme të sistemit bankar të depozitave të GDP-së shënon Mali i Zi me 17.6% dhe



Maqedonia me 33.0%, dhe pastaj vjen Bosnia e Hecegovina me 34.1%. Në anën tjetër pjesën më të madhe e shënon Kroacia me 72.7%.<sup>12</sup>

**Fig. 4. Sistemi bankar i depozitave në % të GDP-së në vitin 2009 në vendet e ballkanit përendimor**



*Burimi:: Business Monitor International (2010); EBRD (2009)*


Shuma e përgjithshme e sistemit bankar të depozitave e përbëjnë 56.6% dhe 51.9% të GDP-së në Bullgari dhe Shqipëri, ndërsa Serbia mbetet nën mesataren e niveleve të regjionit me 39.0%.

<sup>12</sup> Interest Rates in Kosovo, Some Comparisons and Possible Determinates, Valentin Toçi dhe Semra Tyrbedari, Prishtinë, 2005

### 3. Struktura e kredinave

**Fig. 5. Struktura e sektorit të kredive, 2006-2009**

• Korporatat jofinanciare • Sektoret tjera




Burimi: BQK (2010).


Struktura e kredive në industri nuk ka pasur eksperiencë gjatë vitit 2009, për ndryshim duheshin më shumë kredi për fillimin e aktiviteteve të ndryshme të tregtisë, duke ju përmbajtur karakteristikave të Ekonomisë së Kosovës. Kështu vazhdojnë gjatë vitit të mëparshëm, në fund të vitit 2009, ishin 64.4% të shumës së përgjithshme për kredi në industri, pra ishin të garantuara për tregti. Kreditë në sektorin e tregtisë arrinë shumën 249.6 milion euro, që shënojnë rritje vjetore 26.6% në krahasim me vitin 2008.

**Fig. 6. Struktura e kredive në industri, 2008-2009**

*Në dhjetor të vitit 2008*



*Në Dhjetor të vitit 2009*



Burim: BQK(2010).


Kreditë në sektorin e industrive llogariten 48.1 milion euro, pra korrespondojnë me rritje vjetore prej 35.4%. Gjithashtu, rritje e rëndësishme kishte edhe për kreditë në aktivitetet e ndërtimit, e në fund të vitit 2009 arrijnë 6.6% të shumës së përgjithshme të kredive (në industri) në krahasim me vitin 2008 që ishin 4.2%.

*Struktura e kredive të maturimit* në figurë paraqitet një ndryshim gradual në drejtim të kredive me afat të gjatë (3-5 vjet), që marrin hua me marrëveshje me Kreditanstalt für Wiederaufbau's (KfW), e cila siguron burim me afat të gjatë të kredive. Gjithashtu, institucionet mikrofinanciare kanë marrëveshje të ngadalëshme të huave me Agjensinë Evropiane të Rindërtimit (EAR).

Evolucioni pozitiv reflektoj një ofertë të gjerë të shërbimeve financiare nga ana e bankave komerciale dhe aftësi të mira të marrjes së huave të përpunimit të planit të biznesit. Gjithashtu edhe nënshkruajnë siguri në ekonomi. Në veçanti, në fund të vitit 2009, huatë me maturitet përmbi dy vite përfshijnë 44.8% të shumës së përgjithshme të huave, e cila është 12.7% më e lartë në krahasim me vitin 2008. Në pajtim, kreditë me maturim për mbi dy vite arrijnë shumën 230.1 milion euro, që pasqyrojnë 92.1% rritje në krahasim me vitin 2008.<sup>13</sup>

<sup>13</sup> Raporti vjetor i BQK-së, 2010

**Fig. 7. Struktura e kredive të maturimit, 2006-2009**



*Burimi: BQK(2010)*

Kreditë me maturitetet përmbi një vjet dhe mbi dy vjet arrijnë shumën 146.3 milion euro e cila korrespondon me rritje prej 15.6% kundër 49.3% që ishin në vitin 2008. Ulja poshtë e këtyre ndarjeve të shumës së përgjithshme të kredive shkon poshtë 28.5% dhe në fund të vitit 2009 nga 33.9% që ishin në vitin 2008. Kreditë me maturitetet mbi një vjet përfaqësojnë 26.8% të shumës së përgjithshme të kredive (7.3% më e ulët në krahasim me vitin 2008) dhe në fund të vitit 2009 arrinë shumën 137.5 milion euro.

#### **4. Struktura e kushteve të kreditimit**

Pjesën më të madhe të kredive bankare afatshkurtër e përbëjnë kreditë që u lejohen organizatave ekonomike. Banka përherë duhet të jetë në kontakt me organizatat ekonomike, me të cilat ka marrëdhënie afariste të përhershme, duke përcjellë afarizmin e tyre, si dhe duke mbledhur dokumentacionin përkatës, në mënyrë që të jetë në gjendje që ta vlerësojë aftësinë kreditore të çdo organizate ekonomike. Në këtë mënyrë banka do të disponojë shënime të sakta edhe para se ta marrë kërkesën për kredi.

Themi se një organizatë ekonomike ka humbje dhe nuk ka aftësi kreditore, nëse nuk realizon të hyra në lartësinë e të ardhurave personale ose nuk ka mundur ta mbulojë humbjen që është shfaqur në llogarinë përfundimtare. Organizatat ekonomike ka aftësi kreditore nëse realizon rezultat financiar pozitiv, i kthen kreditë me kohë, e ka të

rregulluar si duhet afarizmin financiar dhe e ka kontabilitetin azhur, si dhe nëse tregon realisht pasurinë dhe obligimet e saj.

#### **4.1. Procedura e kreditimit**

Përfshinë kërkesën kreditore dhe shqyrtimin e asaj kërkesë nga ana e bankës.

*Kërkesa kreditore* - duhet të përfshijë këto elemente:

- *qëllimin e shfrytëzimit të kredisë*
- *mënyrën e shfrytëzimit*
- *shumën e kredisë*
- *kushtet e shfrytëzimit (dinamika e shfrytëzimit, afati i kthimit, mënyra e kthimit, etj.)*
- *garancën që ofrohet*
- *shpjegimet plotësuese dhe dokumentacionin që parashihet për llojet e caktuara të kredive*

*Përpunimi i kërkesës kreditore nga ana e bankës* - duhet të bazohet në këtë dokumentacion si:

- *planin e prodhimit, përkatësisht të qarkullimit për vitin vijues sipas sasisë së vlerës*
- *llogarinë përfundimtare për vitin paraprak*
- *llogarinë periodike për vitin vijues*
- *llogaritë mbi shumën minimale të mjeteve xhiruese dhe*
- *pasqyrën e kërkesave nga blerësit sipas afatit*

Sipas nevojës, banka mund t'i vërtetojë gjërat duke shkuar në organizatën ekonomike nëse në bazë të dokumentacionit nuk mund ta marrë vendimin përfundimtar. Po ashtu banka mund të bëjë kontrollin edhe gjatë shfrytëzimit të kredive. Nëse dyshohet se rrezikohet kthimi i kredisë, banka mund të kërkojë garanci të caktuara.

Pas shqyrtimit të të gjithë këtyre elementeve kompetent, i cili merr vendimin mbi lejimin e kredisë dhe lidhet kontrata me shfrytëzuesin ndërsa kur kërkesa refuzohet banka duhet ta njoftojë me shkrim kërkuesin e kredisë me shpjegime përkatëse. Më në

fund, pasi të miratohet kërkesa, faza e fundit ka të bëjë me pagimin e shumës së kredisë në xhirollogarinë e debitorit.

#### **4.2. Kreditimi bankar me afat të shkurtër**

Banka lejon kredi me afat të shkurtër nga mjetet e grumbulluara në formë të depozitave me të parë, nga kreditë afatshkurtëra të Bankës Qëndrore dhe kreditë afatshkurtëra të bankave të tjera.

Gjatë lejimit të kredive afatshkurtëra banka duhet ti përmbahet parimit të likuiditetit dhe të sigurisë d.m.th. të sigurojë kthimin e kredisë së lejuar afatshkurtër pas skadimit të afatit të kthimit të kredisë. Për këtë arsye, banka vazhdimisht duhet të hulumtojë aftësinë kreditore dhe bonitetin e kërkuesit të kredisë, me ç'rast ajo analizon afarizmin e tërësishëm, likuiditetin, rentabilitetin dhe rregullsinë lidhur me përmbushjen e obligimeve të kërkuesit të kredisë dhe ia lejon kredinë atij kërkuesi, i cili me afarizmin e vet dhe me pasurinë që disponon i ofron të gjitha garancitë se kredia do të kthehet brenda afatit të kontraktuar.<sup>14</sup>

Shfrytëzues të kredive afatshkurtër të bankave mund të jenë;

- *organizatat ekonomike*
- *veprimtaritë joekonomike*
- *bankat afariste*
- *prodhuesit bujqësorë*
- *popullsia dhe*
- *organizatat që merren me tregti të jashtme*

#### **5. Norma e kamatës**

Norma kamatës paraqet çmimin e shfrytëzimit të mjeteve monetare e kreditore në tregun financiar. Norma e shfrytëzimit të resurseve monetare gjithmonë është më e madhe në kohën e tashme, sesa në të ardhmen, prandaj duhet të paguhet çmimi i tregut të shfrytëzimit të tyre në një periudhë të caktuar. Kursimtarët ua shesin apo ua japin mjetet e tyre financiare deficitarëve (debitorëve), duke kontraktuar kompensimin

---

<sup>14</sup> Dr. Gazment Luboteni, Bankat dhe Afarizmi Financiar, Prishtinë, 1998, fq. 224.

adekuat apo çmimin (kamatë) dhe periudhën e shfrytëzimit të kapitalit (afatin e kthimit të mjeteve).

Norma e kamatës paraqet instrumentin për baraspeshimin e vëllimit të kursimit dhe të ofertës së kapitalit me kërkesën e resurseve financiare. Kamata e baraspeshuar apo natyrale është ajo kamatë që formohet në nivelin e baraspeshës në mes të ofertës së kapitalit (kredisë) dhe kërkesës së kapitalit (kredisë). Në tregun financiar formohet kamata e tregut, në bazë të raportit në mes të ofertës dhe kërkesës së kredisë.

Ekzistojnë tri teori lidhur me formimin e normave të kamatës në treg:<sup>15</sup>

*1. teoria e preferencës së likuiditetit*

*2. teoria e fondeve kreditore dhe*

*3. teoria e inflacionit të pritur*

**Teoria e preferencës së likuiditetit** – sipas kësaj teorie, normat e kamatës determinohen nga raporti në mes të ofertës dhe kërkesës së resurseve monetare. Ajo bazohet në teorinë e Kejnstit mbi motivet transaksione dhe spekulative për mbajtjen e parave. Vëllimi i parave transaksione varet nga niveli i aktivitetit ekonomik. Vëllimi i parasë spekulative është invers me nivelin e normës së kamatës në periudhat e kamatave të larta.

**Teoria e fondeve kreditore** – sipas kësaj teorie, niveli i kamatës caktohet në bazë të raportit të ofertës e të kërkesës së kredive. Oferta e fondeve kreditore caktohet me vëllimin e kursimit të shoqërisë, përqindjen e rritjes së masës monetare dhe vëllimin e rezervave të resurseve monetare.

Formula e thjeshtuar e fondeve kreditore në këtë formë:

$$LF_s = S + M - RM$$

ku:

$LF_s$  = fondet kreditore

$S$  = kursimi

$M$  = masa monetare

$RM$  = rezervat monetare

**Teoria e inflacionit** – kjo teori bazohet në ndërrimin e normës së kamatës, varësisht nga tendencat inflatore dhe deflatore të ekonomisë. Në kushtet e inflacionit zvogëlohet niveli i fitimit dhe vëllimi i detyrimeve, ndërsa deflacioni ndikon në rritjen e këtij niveli,

---

<sup>15</sup> Dr. Musa Limani, Hyrje në Ekonomi, Prishtinë, 2002, fq. 154.

prandaj për tu ruajtur fitimi i pritur dhe vlera reale e kredive, duke bërë korrigjimin e normës së kamatës.

**Kamata afatshkurtër** – formohet në tregun e parasë në bazë të raportit në mes të ofertës dhe kërkesës së fondeve afatshkurtëra financiare. Kjo kamatë lidhet me kredinë afatshkurtër bankare, letrat shtetërore me vlerë, bonat e arkës, etj. Në kushtet e rritjes së aktivitetit ekonomik rritet edhe kërkesa për këto instrumente dhe në atë rast bëhet rritja e normave të kamatës.

**Kamata afatgjatë** – është e lidhur me kamatën afatshkurtër, pasi si edhe debitorët, ashtu edhe kreditorët ndikojnë në formimin e kamatës në bazë të normave mesatare rrjedhëse dhe normave të pritura afatshkurtëra. Prandaj normat afatgjata të shprehura matematikisht, paraqesin mesataren gjeometrike të ponderuar të normave rrjedhëse afatshkurtër të kamatës. Kur një vend dëshiron që ta rrisë hyrjen e kapitalit të huaj do ti rrisë normat afatgjatë për ta rritur kështu interesimin e investitorëve të huaj që të investojnë në atë vend.

**Kamata reale dhe tregu i kapitalit** – kamata paraqet çmimin për shfrytëzimin e kapitalit të huazuar. Në tregun financiar paraqitet kamata nominale dhe ajo i determinon raportet në mes të ofertës dhe kërkesës së kapitalit hua. Kamata nominale rregullohet me politikën ekonomike dhe monetare. Mirëpo pas kamatës nominale kemi edhe kamatën reale e cila paraqet kamatën nominale të korrigjuar me indeksin e çmimeve me pakicë.

Kamata reale llogaritet me formulën:

$$1 + ir = 1 + ir / 1 + p$$

Kamata reale ( $ir$ ) dhe përqindja e inflacionit ( $p$ ) janë në përpjesëtim të zhdrejtë. Nëse inflacioni është i ultë, atëherë kamata nominale dhe reale gati vijnë e barazohen.



Tabela: 2

<u>Definicionet dhe natyra e të dhënave të mbledhura:</u>	
1. Institucionet raportuese	Të gjitha bankat komerciale të licencuara në Kosovë
2. Instrument financiare	Kreditë Depozitat
3. Deponimi i valutave	Vetëm EUR
4. Shpeshësia	Mujore
5. Palët tjera	Të gjitha korporatat vendore jo-financiare Të gjitha ekonomitë familjare vendore
6. Kontratat e raportuara	Biznesi i ri gjatë muajit referues/shumat e mbetura (varësisht nga lloji i instrumentit financiar, cf.infra)
7. Lloji i normave të kamatës	Norma vjetore e kamatës duke mos përfshirë asnjë ngarkesë apo komision
8. Metoda e llogaritjes	Norma vjetore e kontraktuar (norma e përllogaritur) (varësisht nga tiparet e kontratës specifike, cf.infra)
9. Norma dhe volumi i raportuar	- Një normë e kamatës sipas kategorisë e llogaritur si mesatare me peshë e biznesit të ri të muajit referues apo shumat e mbetura (varësisht nga lloji i instrumentit financiar - cf.infra). Kategoria është definuar nga 5 variabla dhe formon kombinimin për: - llojin e instrumentit financiar - alokimin e sektorit të palës tjetër - afatin e maturimit dhe - shumën e involvuar

Norma e kontraktuar vjetore (AAgR) duhet të raportohet në të gjitha rastet ku nuk ka kapitalizëm apo kapitalizmi ndjek shembullin e rregullt apo kamata ngarkohet mbi kapitalin e mbetur të papaguar dhe nuk jepet kurrfarë periudhe për pagesat e kamatës apo shlyerje të borxhit kapital.

<sup>16</sup> Dr. Muhamet Sadiku, Financimi dhe Zhvillimi i NVM-ve në Kosovë – Raport studimor, RIINVEST, Prishtinë, fq. 74.

Në të gjitha rastet tjera norma vjetore e përlogaritur (AAcR) duhet të raportohet. Kjo është normë vjetore e kamatës që barazon të hyrat e ardhshme diskontuese të parave të gatshme me vlerën nominale të kredisë apo depozitat.

Norma e kamatës e komunikuar nga bankat komerciale nuk mer parasysh normën e kamatës në të gjitha transaksionet individuale gjatë periudhës referuese, përveç për llogaritë e kursimit dhe llogaritë rrjedhëse, ku kamata është llogaritur nga banka si:

- *norma e kamatës në çdo kontratë të mbetur në fund të muajit referues, e peshuar me vlerën e mbetur të kontratës në fund të periudhës referuese, apo*
- *vlera e akumuluar e kamatës (kamata e grumbulluar) gjatë muajit referues e pjesëtuar me mesataren e vlerave ditore të mbetura.*

## PJESA E KATËRT

### IV. SHËRBIMET BANKARE

#### 1. Qëllimi i shërbimeve moderne bankare

Me zhvillimin e bankave bashkëkohore është shtuar edhe numri i shërbimeve që bankat i ofrojnë. Në mbarim të shekullit XX dhe në fillim të shekullit XXI, shërbimet bankare kanë bërë një revolucion në gjithë botën. Shërbimet moderne bankare si: kartelat e debitit dhe kreditit, bankomatat dhe interneti bankar, janë bërë pjesë e pandashme e njerzimit. Bankat kanë ndryshuar në shumë mënyra gjatë viteve. Sot bankat ofrojnë shumë produkte dhe shërbime, që më parë nuk i kanë ofruar, dhe i shpërndajnë këto shumë shpejtë dhe në mënyrë efikase. Por funksioni qëndror dhënia e kredive dhe ndërmjetësimi i pagesave ka mbetur i pandryshuar.

Bankat i mbledhin kursimet e njerzve dhe pastaj ato i japin me kredi tek personat tjerë për të blerë shtëpi, renovuar shtëpi, për të blerë vetura, për zgjerim të biznesit, për financimin e studimeve të fëmijëve të vet dhe për qëllime tjera.

Për shumë njerz bankat janë vende të sigurta për mbajtjen e mjeteve të tyre të cilat i kanë fituar gjatë punës që e kanë bërë. Dikur kompanite e ndryshme, fitimin e vet e kanë mbajtur si para të gatshme dhe pagesat i kanë kryer me mjete kesh. Sot, me zhvillimin e shërbimeve bankare, kjo dukuri nuk qëndron, sepse zhvillimi i shërbimeve bankare mundëson kryerjen e pagesave nëpërmes bankës.

#### 2. Shërbimet bankare

Shërbimet bankare të bankave të cilat veprojnë në Kosovë, krahasuar me shërbimet bankare të bankave në shtetet e zhvilluara, kanë filluar të ngjasojnë. Shumica e shërbimeve moderne bankare që kryhen në bankat më moderne në botë, janë prezente edhe në bankat komerciale të Kosovës.

Shërbimet bankare të cilat bankat e Kosovës i ofrojnë për klientet e vet janë:

##### **-Llogaritë bankare**

- a) *Llogari rrjedhëse* – e cila shërben për deponime, tërheqje, kryerje të pagesave, pranim të rrogës, pranimin e të hollave, etj.

- b) *Llogari kursimi* – e cila llogari shërben për ata persona që dëshirojnë që mjetet të kursejnë dhe njëkohësisht të marrin interes.
- c) *Llogaria me afat* – llogari e cila shërben për persona të cilët dëshirojnë që nga mjetet të cilat i posedojnë dhe nuk ju nevoiten për një periudhë të caktuar, të fitojnë interes.

**-Kartelat bankare** – si shërbim mjaftë modern mundësojnë tërheqjen e parave kesh nëpërmjet ATM-ve dhe pagesa nëpër POS Terminale.

**- Bankomatët** – janë makina elektronike të cilat mundësojnë tërheqjen e parave, kreditimin e llogarive të telefonisë mobile dhe shiqimin e bilancit 24 orë në ditë dhe 7 ditë në javë.

**- POS Terminalet** – janë aparate elektronike të cilët mundësojnë pagesa nëpër dyqane të ndryshme, restorane, etj. me anë të kartelave bankare.

**-Kreditë bankare** – Bankat lëshojn kredi afatshkurtëra apo afatmesme me mjetet e grumbulluara nga depozitat për nevoja të ndryshme të klientëve.

**-Interneti bankar** – është shërbimi më modern bankar, i cili përdoret nga personat të cilët dëshirojnë që ta mbikqyrin llogarinë e vet gjatë gjithë kohës, dëshirojnë të mos humbin kohë për pagesa që kanë për të kryer, dhe raportin për llogarinë e tyre mund ta marrin në çdo kohë.

**-Ceqet bankare** – janë instrument pagese pa para të gatshme të cilët janë të lidhur drejtpërdrejt me llogarinë e klientit.

**-Transferet bankare** – mundësojnë pagesa të faturave të ndryshme, tatimeve, kontributeve, etj. si brenda bankës, në bankat tjera brenda shtetit e poashtu edhe transfera internacional.

**-Garancionet bankare** – janë letra me vlerë të cilat banka i lëshon si garancion për klientin e saj.

**-Letrat kreditore** – janë letra me vlerë të cilat përdoren më së shumti për eksport ose import të mallrave jashtë vendit.

Të gjitha këto shërbime bankat i ofrojnë për të pasur sa më tepër klient, dhe si rrjedhojë do të ketë profit më të madh, ngase të gjitha këto shërbime sigurojnë profit për bankën.

## 2.1. Llogaritë bankare

Bankat në Kosovë ofrojnë tri lloje të llogarive bankare:

- *llogari rrjedhëse,*
- *llogari kursimi dhe*
- *llogari me afat*

*Llogaria rrjedhëse* është llogari bilaterale në mes të bankës dhe mbajtësit të llogarisë. Llogaria rrjedhëse përdoret për të gjitha të hyrat që i ka klienti dhe për të kryer të gjitha pagesat.

Të gjitha bankat që veprojnë në Kosovë, ofrojnë llogari rrjedhëse për klientet e tyre në dy valuta: Euro dhe Dollarë, edhe pse BQK-ja nuk mban rezerva në valuten e Dollarit.

Llogaritë rrjedhëse mund ti hapin personat privat dhe personat juridik. Te llogaritë për persona privat, mbajtësi i llogarisë ka të drejtë ta autorizoj vetëm një person mbi moshën 18 vjeçare. Poashtu dy persona mund të hapin llogari të përbashkët (ang. Joint Account), ku do ti kenë të drejtat e barabarta.

Te llogaritë rrjedhëse për personat juridik, përfaqësuesi ligjor i kompanisë, firmës, etj. është i vetmi person i cili ka të drejtë ta autorizoj kënd dëshiron, dhe ta largoi përsëri. Për çfarëdo ndryshimi në llogari, përfaqësuesi ligjor është ai i cili duhet ta jep urdhërin. Poashtu për personat të cilët dëshiron ti autorizoj në llogari, ai mund t'ia përcaktoj edhe nivelet.

*Niveli 0* – është niveli për llogarit e personave juridik,

*Niveli A* – është për përfaqësuesin ligjor të subjektit juridik, si dhe për personat e autorizuar me të gjitha të drejtat sikur përfaqësuesi ligjor, përveç mbylljes së llogarisë, hapjes së nënllogarive, garancioneve bankare, afatizimeve, aplikimeve për kredi).

*Niveli B* – është nivel i cili i mundëson personit të autorizuar të nënshkruaj vetëm në prezencë të personit me nivel A.

Për hapjen e llogarisë nuk ka nevoj të paguhet asgjë me rastin e hapjes, e poashtu nuk kërkohet as deponim minimal. Në llogaritë rrjedhëse, banka nuk paguan interes, përveç në raste të veçanta për subjekte juridike me të hyra të mëdha. Për mirëmbajtje vjetore të llogarisë rrjedhëse, banka e ndalë një shumë ta caktuar çdo vit.

*Llogaria e kursimit* - për të gjithë ata që dëshirojnë të kursejnë para për të ardhmen, bankat ofrojnë llogari kursimi, në të cilat ipet edhe interes vjetor. Llogaritë e kursimit luajnë një rol shumë të rëndësishëm si për bankën ashtu edhe për ekonominë e shtetit. Sa më shumë që banka të ketë depozita të klientëve në llogari të kursimit, atëherë do të ketë mundësi të lëshoj më shumë kredi për biznese, dhe kështu bizneset zhvillohen, rritet numri i të punësuarve, dhe kështu edhe zhvillohet ekonomia e vendit.

Qëllimi i llogarisë së kursimit është:

- ***deponim dhe tërheqje të parave nga llogaria e kursimit dhe***
- ***pranim i parave me urdhër automatik nga llogaria rrjedhëse në të kursimit***

Bankat në Kosovë ofrojnë edhe llogari të kursimit për fëmijë. Si shembull mund ta përmendim ProCredit Bankën, e cila ofron llogari të kursimit për fëmijë që quhet Pro Kid. Kjo bankë hap falas këtë llogari, dhe për çdo fëmijë që hap këtë llogari, banka ja deponon 5 euro si dhuratë.

Menjëher pas hapjes së llogarisë së kursimit, çdo fëmijë merr librezën e kursimit ku regjistrohen të gjitha transaksionet, kartelën me fotografi të tij/saj, arkën e kursimit, dhe disa dhurata tjera për fëmijë. Në këtë mënyrë fëmiju njoftohet me bankën dhe njekohësisht e fiton edhe shprehinë për kursim.

Llogarinë e kursimit për fëmijë, duhet ta hap njëri nga prindërit, dhe ai është përfaqësues ligjor deri sa fëmiju ti mbush 18 vjet.

Llogaritë e kursimit hapen vëm për persona privat.

Llogaria me afat - nëse posedojmë një sasi të parave të kursyera, dhe jemi të sigurt se nuk do të na nevoiten për një kohë të caktuar, atëherë llogaria me afat është një mundësi mjaft interesante.

Bankat në Kosovë ofrojnë llogari me afat me interesa vjetore të ndryshme, dhe atë për persona privat dhe për persona juridik. Llogaritë me afat ndikojnë drejtpërdrejtë në ruajtjen e likuiditetit. Sa më shumë që ka depozita të afatizuara, dhe në kohë më të gjatë, atëherë ajo ka mundësi të lëshoj kredi me kohëzgjatje më të madhe.

Zakonisht bankat të cilat kanë shumë depozita ofrojnë kushte më të mira për interesa në llogaritë me afat.

Me rastin e hapjes së llogarisë me afat, klienti nënshkruan kontratën dhe pajtohet që deri me datën që është e cekur në kontratë nuk do ti tërheq mjetet e bllokuara. Nëse

klienti dëshiron të prish kontratën para afatit të maturimit, atëherë ai ndëshkohet në kamatën e cila është grumbulluar deri në atë moment.

Paketë llogaria - është një pako llogarishë, të cilën e ka lansuar në treg ProCredit Banka në Kosovë, pako kjo që ka treguar sukses të madh, sidomos në rritjen e numrit të klientëve. ProCredit Banka i ka dizajnuar dy lloje të paketë llogarive të cilat i ka quajtur ProDynamic dhe ProDynamic Plus.

ProDynamic - është pako e llogarive, e cila përmban llogarinë rrjedhëse, llogarinë e kursimit dhe kartel debiti (Maestro ose Visa Electron). Kjo pako ju ofrohet të gjithë klientëve ekzistues dhe klientëve të rinjë, që janë të moshës 16 deri 35 vjeçare.

Për student të cilët e dokumentojnë me faturen e pagimit të semestrit, mirëmbajtja vjetore e llogarisë është pa pagesë. Poashtu klientet të cilët e kanë pakon ProDynamic, për pagesat të cilat i kryejnë nëpër dyqane me kartela bankare, kanë përqindje të bonusit nga banka dy herë më shumë se klientet e zakonshëm.

ProDynamic Plus – është pako e cila është e dedikuar për persona të cilët janë të punësuar dhe marrin rrogë më të madhe se 300 Euro përmes ProCredit Bankës. Dallimi në mes ProDynamic dhe ProDynamic Plus është se ProDynamic Plus si shtojcë përmban edhe kartelë krediti (Master Card ose VISA Classic) dhe mbitërheqje 100% të pagës në minus në llogari rrjedhëse.

## **2.2. Kartelat bankare**

Si shërbim bankar mjaft modern dhe atraktiv për të përfituar klient janë kartelat bankare. Kartela bankare është një plastikë e hollë në formë drejtkëndëshi, e cila ka pjesën e përparme dhe pjesën e pasme. Në pjesën e përparme kemi numrin e llogarisë, numrin e kartelës, emrin dhe mbiemrin e mbajtësit të llogarisë dhe shenjën se çfarë lloji i kartelës është. Kurse në pjesën e pasme është shiriti magnetik (ang. magnetic stripe), shiritin ku duhet ta nënshkruaj mbajtësi i kartelës dhe informatat e bankës që e ka lëshuar si numrin e telefonit të bankës ku klienti mund të kontaktoi me bankën në rast të ndonjë problemi.

Kemi dy lloje të kartelave:

- ***kartela debiti ( ang. Debit Card) dhe***
- ***kartela krediti (Credit Card)***

Këto kartela zakonisht e kanë edhe PIN numrin (Personal Identification Number), i cili shërben për mos keqpërdorim nga personat e paautorizuar.

Bankat të cilat nuk lëshojn kartela bankare debiti dhe krediti, nuk mund të thuhet se kanë shërbime moderne bankare. Sot në Kosovë vetëm dy banka lëshojnë këto lloje të kartelave. ProCredit Bank e cila lëshon kartela të cilat janë të pranishme ndërkombëtarisht si Maestro, Master, Visa Electron dhe Visa Classic, si dhe Raiffeisen Bank e cila lëshon kartela e llojit Visa.

ProCredit Banka është banka e parë në Kosovë që ka filluar të ofrojë kartela bankare që janë të pranishme ndërkombëtarisht, dhe kjo është edhe arsyeja pse kjo bank është banka më e seksusshme në Kosovë.



Fig. 8. Kartelat Bankare (Maestro Card dhe Master Card)



Fig. 9. Kartelat Bankare (VISA Electron dhe VISA Classic)

Këto kartela janë të paisura më çip-in (ang. Chip) më të përsosur që gjendet sot në treg, çka e bën kartelen më të sigurt bankare. Këto kartela ofrojnë lehtësi, fleksibilitet, siguri dhe mënyrë të volitshme të afarizmit bankar, çka e bënë bankën e cila posedon shërbime shumë moderne bankare.



Që të gjitha këto kartela, zëvendësojnë paratë e gatshme dhe ju ofrojnë qasje në të hollat e juaja 24 orë në ditë dhe 7 ditë në javë, madje në tërë botën. Kjo është edhe një arsye për ata persona që kanë vendosur të kenë llogari bankare, ta zgjedhin bankën e cila posedon kartela të këti lloji.

### **2.3. Kartela debiti**

Kartelat e debitit janë mundësi e re e pagesës. Që të dyja këto ju lejojnë që të tërhiqni para të gatshme dhe të bëni blerjen e mallrave të nevojshme, si dhe të bëni pagesa të ndryshme.

Kartela e debitit është e lidhur drejtpërdrejtë me llogarinë rrjedhëse të klientit. Transaksionet e kryera me kartelë debiti, debitohen menjëherë në llogarinë rrjedhëse të klientit dhe mbajtësi i kartelës ka kontrollë të plotë mbi shpenzimet e tij, sepse çdo transakcion paraqitet në gjendjen e llogarisë, dhe klienti mund ta verifikoj çdo veprim të tij.

Siç e cekta më lartë, ProCredit Banka lëshon kartela debiti Maestro Card dhe VISA Electron. Këto kartela janë ndërkombëtarisht të pranuar, dhe aktualisht në mbarë botën ka më tepër se 32 milion tregtarë dhe më tepër se 900 mijë bankomate (ATM), që i pranojnë këto kartela.

Përdorimi i kartelave debiti është shumë më i sigurt sesa mbajtja e të hollave të gatshme (keshit), sepse përveç që i shmangeni rrezikut të plaqkitjes, i shmangeni edhe mundësisë së mashtrimit me banknote falco.

Nëse neve na humbin paratë e gatshme, atëherë ato i kemi humbur përgjithmonë, ndërsa nëse e humbim kartelën bankare, ajo çka duhet bërë është vetëm ta njoftojmë bankën që ta bllokoi kartelën dhe të kërkojmë kartelë të re me kod (PIN) të ri. Askush përveç personit që e din kodin e fshehtë të kartelës nuk ka mundësi ta përdorë kartelën apo ti qaset xhirollogarisë së asaj karteje.

Për kartelat e debitit në ProCredit Bank mund të aplikoj çdo person që posedon llogari rrjedhëse. Këto kartela për klientët e saj kjo bankë i lëshon falas.

Me këto kartela mund të shpenzoni aq të holla sa ju zotëroni në llogarinë rrjedhëse bankare, përfshirë këtu edhe mbitërheqjen në minus nëse e keni të lejuar nga banka.

Bankat të cilat e ofrojnë këtë shërbim modern, klientët e vet i kanë shumë të kënaqur, kjo për shkak se këto kartela mund ti përdorin edhe jashtë Kosovës, duke ju shmangur obligimit të këmbimit të valutës, apo edhe të mbajnë shuma të mëdha të të hollave.

ProCredit Banka ka të instaluar më shumë se 1000 POS Terminale apo ndryshe quhen edhe pika të shitjes (ang. Point of Sale), nëpër dyqane në mbarë Kosovën, dhe kështu ju mundëson klientëve të vet që të paguajnë me kartela, për gjërat e nevojshme dhe shërbimet tjera. Gjithashtu ka mbi 50 Bankomate (ATM) të vendosura në mbarë Kosovën, të cilët mundësojnë tërheqjen e parave kesh në çdo kohë.

Kryerja e pagesave nëpërmes kartelave bankare ka shumë anë positive. Në njërin anë klienti i cili bën pagesa me kartelë i ikë mundësisë së pranimit të ndonjë banknote falco nga tregtari, në anën tjetër për autoritetin tatimor kjo shkon në dobi se tregtari nuk ka mundësi të bëjë evazion tatimor duke e fshehur qarkullimin ditor dhe në fund kjo për bankën sjell profit në çdo mënyrë.

Pagesat me kartela bëhen në mënyrë shumë të thjeshtë dhe në mënyrë të njëjtë si në Kosovë ashtu edhe jashtë saj. E tëra çfarë nevojitet për ta bërë një pagesë është që kartelën tuaj bankare të ja ipni tregtarit, i cili më pas do ta përshkoj shiritin magnetik të kartelës në POS terminal, dhe pastaj mbajtësi i kartelës duhet ta autorizoj këtë transaksion duke e shtypur kodin e fshehtë. Nëse mbajtësi i kartelës nuk posedon fonde të mjaftueshme në llogari atëherë transaksioni nuk do të kryhet, përndryshe nëse posedon mjete, atëherë pagesa kryhet me sukses dhe konfirmimi që del nga POS Terminali duhet të nënshkruhet nga klienti.

#### **2.4. Kartela krediti**

ProCredit Bank është e vetmja bankë në Kosovë që ofronë kartela krediti të vërteta, me funksionalitetin e Master Card-ës dhe VISA Classic-it.

Të gjithë klientet e paisur me kartelë kredie kanë një kufi standard mujor të shpenzimeve dhe nuk paguajnë ineters deri në datën e caktuar për shlyrjen e shpenzimeve.

Kur me përdorimin kartelë kredisë, nuk jemi të detyruar të paguajmë menjëherë vlerën e transaksionit që e kryejmë. Shuma e përgjithshme e transaksioneve të kryera

gjatë një muaji debitohet nga llogaria rrjedhëse në ditën e parë të muajit pasues. Mbajtësi i kartelës së kredisë ka kohë ta deponojë shumën që është minus, deri në fund të muajit në llogarinë e tij rrjedhëse. Me datën 1 të muajit pasues, banka e debiton llogarinë e tij rrjedhëse, dhe në këtë mënyrë e barazon kartelën e kredisë.

Poashtu edhe me kartelë krediti, klienti ka qasje të bëjë tërheqje dhe pagesa 24 orë në ditë dhe 7 ditë në javë. Tërheqja e parave kesh me kartelë krediti është me provizion, kurse nëse bënë pagesa nëpër POS Terminale atëherë nuk ka provizion nga banka. D.m.th. kartela krediti është e preferuar më shumë për pagesa, sidomos në internet.

Për të aplikuar për këtë kartelë, duhet të jeni mbi moshën 18 vjeçare, të keni të ardhura mujore nga paga mbi 300 euro, të paguara përmes llogarisë në ProCredit Bank, apo duhet të bllokoni 120 % të limitit shpenzues që dëshironi ta keni në kartelë, si garancion për bankën.

Përparësia e kësaj kartele, ndryshe nga kartela e debitit, është se me këtë kartelë mund të bëjmë pagesa përmes internetit, mund të bëjmë thirrje nëpër telefonat publik, është mundësi pagese me vonesë, mund të blejmë bileta aeroplani, rezervime të hoteleve, marrje të veturave me qera, etj. Mund të themi se roli i kartelave në shërbimet bankare është shumë i madh. Banka ka relacione shumë të mira me klient dhe poashtu klientët kanë interes nga banka.

Kur jemi tek Procredit Bank, duhet të përmendi edhe një shërbim mjaft të mirë, të cilin ProCredit Bank ia ofron klientëve të vet.

Të gjithë në ProCredit Bank të cilët i posedojnë kartelat Maestro, Master, VISA Electron dhe VISA Classic, dhe që kryejn pagesa nëpër POS Terminale, banka ju dhuron bonus si stimulim për ta ngritur numrin e pagesave me kartela bankare, e poashtu edhe disa dyqane të ndryshme, restorane, hotele mund të dhurojnë bonus për klienta të cilët kryejnë pagesa me këto kartela. Në këtë kartelë nuk mund të deponohet në të, e as të tërhiqet bonusi i akumuluar në të. Ky bonus i akumuluar mund të shpenzohet prap duke bërë pagesa nëpër partnerë e kontraktuar të ProCredit Bank-ës që i kanë POS Terminalet e instaluar. Në ekonomitë e zhvilluara dhe moderne pjesa më e madhe e pagesave kryhet përmes kartelave elektronike e jo me para të gatshme.



Fig. 10. ProBonus kartela.

Pro Bonusi është një mundësi atraktive për të krijuar një rrjet i cili kontribon që edhe në Kosovë pagesat të kryhen përmes kartelave bankare. Pagesat me kartela bankare zvogëlojnë manipulimet kundër autoriteteve tatimore, i ikë mundësisë së pranimit të banknotave falco dhe është mjet shumë efikas për mos pranimin e gumave përlypëse në vend të mbetjes (kusurit).

## 2.5. Bankomatat (ATM)

ATM-të (Automatic Teller Machine) janë makina elektronike të cilat bëjnë tërheqjen e parave në kesh, 24 orë në ditë dhe 7 ditë në javë.

Bankomatat në Kosovë për herë të parë i ka instaluar ProCredit Bank në vitin 2003, pastaj i instaloi edhe Raiffeisen Bank, dhe në muajin prill 2005 edhe BpB-ja filloi instalimin e tyre. Momentalisht ProCredit Bank ka të instaluar mbi 50 ATM në tërë territorin e Kosovës.

Për tërheqjen e parave kesh nëpër bankomata, duhet poseduar kartelën bankare së bashku me kodin e fsheht. Bankat e caktojnë limitin e tërheqjes së parave brenda 24 orëve, p.sh. ProCredit bank e ka limit 500 Euro brenda 24 orëve.

Çdo bank e cila posedon bankomata të instaluar, mund të thuhet se ka shërbime moderne bankare. Bankomatat janë një arsye më shumë për persona të cilët dëshirojnë të antarësohen në bank.

Shërbim mjaft efikas të cilin ATM-të e ProCredit Bank-ës e ofrojnë është edhe pagesa e faturave të rrymës përmes bankomatit. Nëse posedon kartelë të kësaj banke atëherë mundesh ta kursesh veten nga mundimi i shkuarjes deri në KEK për pagesa të faturave të rrymës, të cilat lirisht mund ti paguash përmes bankomatit në çdo kohë.

## 2.6. POS Terminalat

POS Terminalat janë paisje elektronike, të cilat duke e lexuar shiritin magnetik të kartelës bankare, mundësojnë transferin e fondeve nga llogaria e blerësit në llogarinë e tregtarit. Këta janë zakonisht të lidhur me telefon dhe njëkohësisht edhe me llogari rrjedhëse në bank.<sup>17</sup>

Instalimi i POS Terminalave nga banka tek tregtarët e ndryshëm, është një shërbim bankar mjaft modern që ka qenë prezent në bankat e shteteve të zhvilluara, kurse në Kosovë banka e parë dhe momentalisht e vetme që ofron mundësi pagese me kartelë tek tregtarët, është ProCredit Bank.

ProCredit Bank, POS Terminalat i ofron falas për tregtarët të cilët janë të interesuar për këtë shërbim dhe i pranojnë disa kushte të thjeshta nga banka. Poashtu trajnimi për përdorimin e POS-ave si dhe mirëmbajtjen e tyre e kryen vet banka.

Shtrohet pyetja, si do të ndihmojnë POS Terminalat që biznesi i një tregtari të zgjerohet?

Përgjigjja është kjo:

- *blerja është shumë e shpejtë (disa sekonda)*
- *siguri – shitësi e pranon gjithë shumën në llogarinë e tij bankare,*
- *rreziku i gabimeve gjatë numrimit me kesh nuk ekziston,*
- *humbja e cila shkaktohet nga pranimi i banknotave falco nuk ekziston,*
- *eliminon rrezikun e mbajtjes së shumave të mëdha të parave të gatshme në dyqan,*
- *nuk shpenzon kohë që pazarin ditor ta dorëzosh fizikisht në bankë.*
- *e rritë qarkullimin duke:*
  - *mos i kthyer klientët të cilët kanë dashur të bëjnë pagesa në kartela bankare*
  - *i shërbyer vizitorët e huaj që kanë kartela internacionale dhe njëkohësisht ata nuk shpenzojnë kohë për këmbimin e valutave në euro.*
- *e rritë edhe shitjen - sepse klientët kanë shuma më të mëdha në llogari bankare se sa kesh dhe kështu ata mund të shpenzojnë më shumë*

---

<sup>17</sup> Structure of Commercial Banking Sector, 2005

- *nëse ke Pos Terminal të instaluar je më konkurentë në treg se sa ata që nuk kanë*
- *dhe gjithashtu e ngrit imazhin e kompanisë duke ofruar shërbime moderne të pagesës dhe duke i realizur kërkesat e konsumatorit.*

## **2.7. Kredia dhe llojet e kredive**

Funkcioni më i rëndësishëm i bankave është dhënia e kredive. Kreditë bankare kontribuojnë në zhvillimin dhe rritjen e shumë ndërmarrjeve të vogëla e të mesme. Llojet e kredive që më se shumti ipen nga bankat e Kosovës janë:

- *kredia private,*
- *kredia konsumuese,*
- *kredi për biznes,*
- *kredi për renovim,*
- *kredi për bujqësi (agro kredi),*
- *kredi për automjete,*
- *kredi për shkollim dhe*
- *mbiterheqje (overdraft).*

## **2.8. Kredia private**

Kredia private është kredi afatshkurtër me rikthim të rregullt e dedikuar vetëm për persona privat që kanë të ardhura stabile nga paga apo pensioni. Destinimi i kredisë nuk është i kufizuar. Zakonisht afati i kthimit është prej dy deri në tri vite, varësisht nga politika e bankës.

Si instrument sigurimi merret një anëtar i familjes së ngushtë mbi moshën 18 vjeçare, i cili do të jetë edhe si bashkë-huamarrës për kredi.

Zakonisht shuma e cila ipet me kredi, tek kreditë private është nga 250 euro deri në 5,000 euro.

## **2.9. Kredia konsumuese**

Me kredi konsumuese banka e financon blerjen e produkteve të konsumit, të cilat mund të blihen te partnerët e bankave.

Kredia konsumuese është poashtu kredi afatshkurtër me rikthim të rregullt, e dedikuar vetëm për persona privat me rrogë apo pension të rregullt. Kjo lloj kredie ofrohet në publik vetëm nëpërmes tregtarëve të cilët nënshkruajnë marrëveshje me bankën, në mënyrë që banka të ja financoj blerjet, që ndryshe këta quhen edhe „partner“.

Destinimi i këtyre kredive është blerja e mallrave nga partnerët e bankës. Afati i maturimit është prej 16 muajve deri në 24 muaj. Minimumi i shumës së kredisë është 250 euro, ndërsa maksimumi 5,000 euro. Procedurat e aplikimit janë të njëjta sikur për kredi private.

## **2.10. Kredi për biznes**

Me kredi për biznes, banka plotëson nevojat financiare si për mjete qarkulluse ashtu edhe për mjete themelore. Destinimi i këtyre kredive është financim plotësues për huamarrësin, që të iu ndihmojë në zhvillimin e biznesit dhe në blerjen e mjeteve fikse.

Kreditë për biznes janë kredi të cilat kanë kontribut shumë të madh në zhvillimin ekonomik të vendit. Sa më të mira të jenë kushtet e kreditimit (sa më të vogla interesat), do të kemi rritje të numrit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, e me këtë edhe rritje të numrit të të punësuarve dhe zhvillim ekonomik më të madh.

Në Kosovë, intereat bankare për kamata janë kryesisht të larta, më të lartat në rajon. Mund të thuhet se këtë e shkakton edhe mos siguria e kthimit të kredive, mungesa e ligjit rigoroz, etj.

Zakonisht për marrjen e kredisë për biznes, bankat e Kosovës kërkojnë garantues dhe hipotek deri 150% të shumës së kredisë.

Si kredi për biznes, janë edhe kreditë ekspres, të cilat destinohen poashtu për financimin e mjeteve, e poashtu edhe për mjete themelore. Këto dallojnë vetem për nga shpejtësia e disbursimit dhe shumat janë më të vogla.

## 2.11. Kredi renovimi

Me kredi renovimi për shtëpi apo banesë, banka financon përmirësimin e kushteve të banimit apo finalizimin e punëve ndërtimore.

Kredia për renovim është kredi afatmesme apo afatgjatë për përmirësimin e kushteve të popullsisë. Destinimi i këtyre kredive është: ndërtimi, finalizimi, renovimi, rikonstruktimi, zgjerimi dhe blerja e njësisë të shtëpisë apo banesës.

Kohëzgjatja e kthimit të këtyre kredive është deri në 5 vite, kurse ProCredit Bank tani ka filluar edhe lëshimin e kredive për renovim edhe deri në 7 vite me afat kthimi.

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë ata persona të cilët kanë rrogë apo pension stabil apo kanë të ardhura stabile nga biznesi. Për kredi renovimi si mjet sigurie merret edhe një garantor, si dhe për shuma mbi 10,000 euro merret edhe hipotekë.

Kreditë për renovim kanë rol të madh në zhvillimin e infrastrukturës dhe në përmirësimin e kushteve të jetesës së njerëzve.

## 2.12. Kredi për bujqësi

Me kredi për bujqësi, banka përkrahë financiarisht të gjithë ata që merren me bujqësi, agrobiznese dhe biznese rurale.

Destinimi i kredive për bujqësi është:<sup>18</sup>

- *zgjerimi i fondit të bagëtisë,*
- *rregullimi i fermës,*
- *blerja e paisjeve bujqësore,*
- *përgaditja për sezon, etj.*

Afati i kthimit të kredive për bujqësi, në bankat që veprojnë në Kosovë është deri në 24 muaj. Edhe këtu si mjet sigurie kërkohet hipotekë deri në 150% të shumës së kredisë.

Kreditë për bujqësi ndikojnë shumë në zhvillimin e bujqësisë, e poashtu edhe në zhvillimin ekonomik të shtetit. Sa më shumë që financohen bujqit, atëher do të kemi më shumë prodhime vendore dhe nuk do të kemi nevojë për import.

---

<sup>18</sup> Dr. Sulo Hadri, *Ekonomia Monetare, Ribotimi 4*, Tiranë, 2003, fq. 189.



### **2.13. Kredi për automjete**

Me kredi për automjete, Banka e financon blerjen e automjeteve të reja përmes partnerëve të bankës. Banka e financon deri në 80% të çmimit të automjeteve duke përfshirë doganën dhe TVSH-në.

Për aplikimin e këtyre kredive, duhet të kemi të ardhura të rregullta nga paga ose pensioni, apo të kemi të ardhura stabile nga biznesi.

Afati i kthimit të këtyre kredive është 48 muaj.

Si instrumente sigurimi të kredisë merret:

- *bashkëmarrës dhe një garantues,*
- *pengu mbi automjetin e financuar,*
- *polisa e sigurimit "kasko e plotë" për automjetin e financuar deri në përfundimin të kredisë dhe*
- *ndalesa administrative mbi pagën.*

### **2.14. Kredi për student**

Me kredi për student, banka financon shkollimin e studentëve. Afati i kthimit është deri në 60 muaj.

Këtu mund të lejohet grejs periudha. Si instrument garancioni merret një bashkëmarrës (anëtar i familjes) dhe një garantues.

### **2.15. Mbitërheqja (Overdraft)**

Me mbitërheqje, banka ia lejon klientëve të vetë mbitërheqje nga llogaria e tij rrjedhëse, edhe pse nuk posedon mjete në të, për shumë të caktuar dhe interval të caktuar.

Te mbitërheqja kamata llogaritet në baza ditore dhe vetëm për ditët kur llogaria është minus. Mbitërheqja është lloj kredie që për kompanitë e mëdha është shumë e levërdishme.

## 2.16. Interneti bankar (E-banking)

Interneti bankar është një shërbim mjaft modern bankar të cilin e posedojnë shumica e bankave në shtetet e huaja. Interneti bankar të ndihmon të kursesh kohën, të garanton përshtatmëri dhe siguri për ty dhe biznesin tënd.

Përmes internetit bankar kemi qasje 24 orë në ditë dhe 7 ditë në javë në llogaritë tona nga cilido kënd ose cilido kompjuter i cili ka internet.

Në desktopin (monitorin e kompjuterit) ne mund të shohim kur kemi dëshirë informacionet komplete për llogaritë të cilat i kemi të hapura në bank. Kemi mundësi të shohim edhe informatat mbi pagesat që na kanë bërë (d.m.th. kush ka qenë pala urdhëruse).

Interneti bankar është shumë i shpejt dhe efikas. Përmes tij mund të ekzekutosh shpejt këto operacione bankare: urdhër pagesat brenda bankës, urdhër pagesat në mes të bankës, urdhër pagesat për tatime, kontribut pensione, urdhër pagesat për dogana, sigurim, etj., urdhër pagesat për fatura të ndryshme, urdhër pagesat internacionale (në shtete të ndryshme), urdhër pagesat internacionale në shumë valuta të huaja, etj.

Poashtu nëpërmes internetit bankar ne mund të kryejmë edhe shumë shërbime si: raportin e bilancit dhe lëvizjet në llogaritë tona në atë bankë, gjendjen ditore të llogarisë, kursin e këmbimit të valutave të huaja, interesat bankare që afron për depozita, kushtet dhe termat e përgjithshme bankare, raportet për qasje në sistem, lajme të ndryshme për rrjetat në bankë, etj.

Interneti bankar është shumë i sigurt. Ky është një sistem i cili garanton siguri maksimale për informatat e juaja bankare. Aty keni qasje vetëm ju, apo edhe ndonjë person tjetër që është i autorizuar nga ju.

Pasi që të rregjistroheni për internetin bankar ju e zgjedhni emrin e përdorurit dhe posedusit, të cilat e dini vetëm ju, dhe të cilat e mundësojnë që të kemi qasje në internetin bankar.

Shumica e personave që fillojnë përdorimin e internetit bankar e bëjnë atë për arsye se atyre iu nevojitet të paguajnë faturat shumë shpesh dhe kanë dëshirë ta bëjnë me përpjekje minimale. Përveç kësaj, njerëzit e përdorin internetin bankar për të pasur mundësi që në çdo kohë ta shiqojnë llogarinë e vet, pagesat të cilat i kanë fletë në llogarinë e tij.

Interneti bankar është zhvilluar në shumë shtete, janë afër 10 milion përdorues të internetit bankar në Amerikë, dhe numri i bankave të cilat e ofrojnë këtë shërbim arrin në 5,000.

Sa i përket Kosovës, banka e parë e cila e ka filluar internetin bankar si shërbim mjaft modern për klientët e saja është Banka e Re e Kosovës. Nga fundi i vitit pritet që edhe PCB të lançoj poashtu këtë shërbim për klientët e saj.

## **2. 17. Çeqet bankare**

Në Kosovë momentalisht bankat shesin çeqe vetëm për persona juridik. Këto çeqe mund të inkasohen vetëm nëse kompania që i ka lëshuar ka fonde të mjaftueshme në llogari përndryshe çeku konfiskohet. Çeqet mund ti inkasoj vetëm personi kurse i të cilit është i shënuar në çek.

Disa banka në Kosovë pranojnë edhe çeqe të shteteve të ndryshme. Këto çeqe quhen çeqe për koleksion. Këto nuk inkasohen menjëherë, por dërgohen në bankën që i ka lëshuar për verifikim. Pasi të verifikohet, atëherë ajo shumë i paguhet klientit.

Çeqet bankare janë instrument pagese të cilët janë të lidhur me llogarinë rrjedhëse të personit privat apo të kompanisë, dhe mundësojnë pagesa pa kesh. Banka të lëshon një bllok çeqesh (në përgjithësi 10), me të cilën mund të paguash blerjet e kredinave dhe shërbimeve.

PCB është e vetmja bank që është e autorizuar që të bëjë shitjen e çeqeve të udhëtimit (Traveller's Chague) Thomas Cook. Çeqet e udhëtimit zakonisht përdoren në rastet kur udhëtojmë jashtë shtetit, dhe për ti ikur rrezikut, mund të blejmë çeqe të udhëtimit dhe pastaj ato mund ti inkasojmë kurdo dhe kudo.

Ka raste edhe kur ambasadat e ndryshme i kërkojnë nga personat të cilët aplikojnë për viza nga ajo ambasadë. Ambasada kërkon çeqe të udhëtimit për tu konfirmur se posedojmë mjete me vehte.

## 2.18. Transferat bankar

Me transfer bankar kuptojmë kalimin e mjeteve prej një llogarie në një llogari tjetër, bank tjetër, shtet tjetër, etj.

Kemi tri lloje që përdoren më së shpeshti te transferat bankar:

- *transferat nëpërmes bankës (brenda bankës),*
- *transferat nacional (brenda shtetit) dhe*
- *transferat internacional.*

Transferat mbrenda bankës, janë transferat të cilët kryhen mbrenda ditës, ku urdhëruesi është klient i bankës, e gjithashtu edhe përfituesi është klient i të njëjtës bankë.

Transferat nacional, janë transfer i mjeteve nga një bank në bankën tjetër. Nëse urdhëruesi është klient i një banke, dhe ka ti bëjë pagesë një personi apo kompanie i cili është klient i bankës tjetër, atëherë kjo pagesë duhet të shkoj përmes Bankës Qëndrore.

Transferat internacional, janë gjitha urdhërat e transferave të mjeteve nga njëra nga bankat që veprojnë në Kosovë, në bankat jashtë Kosovës.

Urdhëruesi (klienti) i cili dëshiron të transferoj mjete në bankat jashtë Kosovës, duhet të posedoj nr. e llog. së përfituesit, emrin e mbajtësit të llogarisë, emrin e bankës, degën, adresën e bankës dhe SWIFT kodin.

Provizioni për dërgimin e transferave internacional, ndryshon shumë pak në mes bankave në Kosovë.

Klienti mund të zgjidhë mënyrën se si do ta paguaj provizionin e transferit. Mund ti paguaj vetëm shpenzimet e bankës së vet urdhëruese ose mund të paguan të gjitha shpenzimet (bankës urdhëruese + bankës ndërmjetësuese + bankës së përfituesit).

Në bankat e Kosovës provizioni për shpenzimet e bankës për transferat internacional sillet nga 0,2 % deri 0,3 % varet nga politika e bankës.

Transferat e parave nëpërmjet bankës është mjaft shërbim modern në ditët e sodit. Ka kaluar koha kur për pagesa të ndryshme është nevojitur të rezikohet, që paratë të barten fizikisht prej një vendi në tjetrin, apo nga një qytet në tjetrin, prej një shteti në shtetin tjetër, shërbimet bankare kanë bërë një lehtësim mjaft të madh sidomos për biznesmenët të cilët importojnë apo eksportojnë mallra jasht shtetit.

## **2.19. Pagesa e rrogës përmes bankës**

Pagesa e rrogave të punëtorëve përmes bankës është një shërbim modern dhe shumë i aplikuar në shtete të ndryshme. Nga ky shërbim kanë profit bankat në rend të parë, autoritetet tatimore (punëtorët paguajnë tatimin në të ardhura) dhe vet punëtori që e pranon pagën përmes bankës, sepse mund ta shfrytëzoj më vonë për aplikim të kartelës së kreditit, etj.

Procesi i transferit të rrogave nga kompania tek punëtorët e saj është shumë i tjeshtë dhe shumë i shpejtë. Banka e hap llogarinë e kompanisë, dhe njëkosisht hap falas edhe llogaritë bankare për të gjithë punëtorët e asaj kompanie. Të gjithë ata të punësuar do të marrin kartelë bankare. Kompania i sjell listat e rrogave në bankë në CD apo floppy disk, dhe në të njëjtën ditë banka e bënë procesimin e rrogave, dhe të punësuarit mund ti marrin në kartelat e tyre në të njëjtën ditë.

Ky shërbim e kursen mjaft kohën e personit të antarësuar të një kompanie, i cili e bënë shpërndarjen e rrogave, nuk ka nevojë të bëjnë banknota me vlera të vogla, etj.

Pastaj, pagesa e rrogave përmes llogarisë bankare, shkon në favor edhe të të punësuarëve, sepse mund të shfrytëzojnë edhe shumë shërbime tjera bankare, si kredi të ndryshme, kartela krediti, etj.

## **2.20. Urdhërat automatik (Standing Orders)**

Me shërbim "urdhër automatik" kuptojmë urdhërin të cilin mund ta jep klienti tek banka, (duke nënshkruar një form), që në ditën e caktuar dhe kohëzgjatjen e caktuar, llogaria e tij të debitohet dhe të kreditohet llogaria që ai duhet të bëjë pagesa.

Si shembull, personat që pranojnë pagën përmes bankës, mund të hapin edhe llogari kursimi, dhe mund të bëjnë një urdhër automatik që sa herë ta pranojnë pagën, banka ta debitojë llogarinë rrjedhëse dhe ta kreditojë llogarinë e kursimit, për shumën që ai peron e cakton. Ky shërbim është shumë i mirë ngase i shtyn njerëzit që të kursejnë.

Ky urdhër mund të përdoret poashtu edhe në ato raste kur paguajnë ndonjë qera rregullisht çdo muaj, apo diçka tjetër.

## 2.21. Garancionet bankare

Garancioni bankar është një letër me vlerë të cilën e lëshon banka për t'ia mbuluar detyrimet debitorit (klientit), në favor të kreditorit (përfituesit), me kushtet të cilat janë të shkruara në garancionin bankar.

Bankat e Kosovës lëshojnë të gjitha llojet e garancioneve bankare vetëm në dy valuta (Euro dhe Dollar).<sup>19</sup>

Poashtu bankat lëshojnë edhe garancione bankare:

- *indirekte (internacionale)*
- *direkte (lokale-vendeve).*

Llojet e garancioneve bankare janë:

- *garancione për pagesa,*
- *garancione për sigurim të punës,*
- *garancione për participim në ankande (tendera),*
- *garancione për qëllime doganore,*
- *garancione për kthim të avanseve të paguara,*
- *garancione për ankesa për mos fitimin e tenderit,*
- *garancione kreditore, etj.*

Për ekonominë e Kosovës rol të madh kanë edhe garancionet indirekte (internacionale) bankare. Në rast se ndonjë biznesmen dëshiron të importoj ndonjë gjë nga shtetet e ndryshme, si dëshmi për pagesë mund ta dërgon një garancion bankar i cili pranohet nga banka e përfituesit.

---

<sup>19</sup> BULETINI I BQK-së, 2010

## PËRFUNDIMI

Pas përfundimit të luftës në Kosovë, pothujase shërbimet bankare nuk kanë ekzistuar fare, por për një periudhë afatshkurtër, me konsolidimin e BQK-së dhe hapjen e bankave komerciale, shërbimet bankare u janë ofruar bankave evropiane.

Përveq shërbimeve bankare, besimi në banka dita ditës rritet dhe te popullata po shtohet vetëdijësimi se bankat janë institucione financiare të sigurta për ruajtjen e mjeteve të tyre. Tani të gjitha bankat i kryejnë shërbimet e njëjta dhe e vetmja gjë e cila i josh klientët është respekti, azhureteti dhe preciziteti i shërbimit. Gjatë punimit të diplomës kam bërë përpjekje që të përfshijë të gjitha shërbimet bankare të cilat tani i kryejnë bankat e Kosovës. Të metat kryesore të sistemit bankar në Kosovë janë kamatat e larta dhe koha e shkurtër e kthimit të kredive. Pjesa më e madhe e depozitave të kosovarëve janë të deponuara jashtë vendit.

Bankat arsyetohen se legjislacioni ekzistues në vend nuk iu krijon atyre komoditetin e rritjes së nivelit të kredive. Bankat ankohen se atyre ju mungojnë mekanizmat e detyrimit të kthimit të kredive dhe për këtë arsye ato janë shumë të matura në lejimin e tyre. Edhe në këto rrethana pjesëmarrja e kredive të këqija me gjithë kreditë e lejuara është ende e ulët.

Një e metë tjetër në menaxhimin e bankave është vërejtur edhe në rastet kur aksionarët e disa bankave ndikojnë drejtpërdrejt në punën e menaxhmentit dhe nuk i lënë këta të fundit që ta kryejnë punën në mënyrë profesionale. Ekzistojnë shumë raste kur aksionarët e caktuar ndikojnë në dhënien e një kredie, madje edhe kur subjekti i caktuar nuk i plotëson kriteret e parapara.

Struktura depozitave të bankave komerciale në Kosovë shënuan rritje të vazhdueshme. Kjo lidhet me kthimin e besimit të ekonomisë dhe popullsisë, përkatësisht depozitarëve, në sistemin bankar i cili ishte i humbur në sistemin e vjetër. Rritja e depozitave është veçmas intensive gjatë dy viteve të fundit për shkak të vlerës së qëndrueshme të euros në krahsim me valutat tjera. Në shtjellimin e punimit të diplomës kam përdorur metodën e analizes funksionale strukturore me qëllim kërkimor në lëmin e bankave dhe metodën e konkretizimit, ku janë dhënë shënime konkrete të përcjellura me elemente të metodës së numrimit të të dhënave të paraqitura.

## LITERATURA

1. BQK BULETIN, 2010
2. Haderi, Dr. Sulo, Ekonomia Monetare, ribotim i katërt, Tiranë, 1998
3. Limani, Dr. Musa, Hyrje në Ekonomi, Prishtinë, 2002
4. Luboteni, Dr. Gazmend, Bankat dhe afarizmi bankar, Prishtinë, 1998
5. Luboteni, Dr. Gazmend, Bankat dhe afarizmi bankar, Prishtinë, 2006
6. Raporti vjetor i BQK-së
7. Sadiku, Dr. Muhamet, Financimi dhe Zhvillimi i NVM-ve, Prishtinë, 2007
8. Structure of Commercial Banking Sector, 2005
9. Toçi, Dr. Valentin dhe Tyrbedari, Dr. Semra, Interest Rates in Kosovo, some Comparisons and Possible Determinates, Prishtinë, 2005

### **Lincet**

[www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)

[www.odaekonomike.org](http://www.odaekonomike.org)

[research@bqk-kos.org](mailto:research@bqk-kos.org)